

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6166
E hënë, 16 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria thotë se ka rritur kapacitetet shëndetësore për përballje me Covidin

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTAKUZAT E GJYKATËS SPECIALE KUNDËR ISH-KRERËVE TË UÇK-SË KANË NDRYSHUAR EDHE RRJEDHËN E SITUATËS POLITIKE NË KOSOVË

FAQE 4-5

ZGJEDHJET E REJA, TË PASHMANGSHME



Pas zhvillimeve të fundit në Kosovë, ngritjes së aktakuzave nga Gjykata Speciale kundër ish-krerëve të UÇK-së, ka filluar të diskutohet si ide shkuarja e vendit në zgjedhje të reja parlamentare. Lideri i Lëvizjes

Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhjet e reja duhet të mbahen sa më parë. Edhe deputeti i PDK-së, Kujtim Gashi, ka thënë se qeveria Hoti sa më parë duhet të ikë. Mendim për zgjedhje të reja kanë shprehur

edhe analistët politikë Shkëlzen Maliqi dhe Belul Beqaj, të cilët kanë vlerësuar se zgjedhjet e reja në Kosovë janë të pashmangshme. Ata kanë theksuar se vendit i duhet një qeveri më e gjerë



KRYETARI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

KURTI KËRKON NGA QEVERIA QË TA MBROJË UÇK-në NË HAGË

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për media mbajtur të dielën, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për mbrojtjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ish-ushtarëve të tjerë të UÇK-së të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale për krime lufte në Hagë. Lideri i LV-së ka bërë thirrje që për luftën çlirimtare të jenë unikë. "Ne duhet të jemi bashkë për luftën tonë çlirimtare dhe kundër Serbisë e cila nuk na njeh sepse është e papenduar për krimet e kryera", ka thënë Kurti

FAQE 5

SAMI LUSHTAKU KËRKON NGA POLITIKANËT E SHQIPËRISË TË JENË MË AFËR KOSOVËS

FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



TRUMPI JEP SINJALE SE E KA PRANUAR FITOREN E BIDENIT F. 3

LIBURN ALIU, USHTRUES I DETYRËS I SHEFIT TË GRUPIT PARLAMENTAR TË LV-së F. 3

PUNËTORËT E TELEKOMIT SOT PROTESTOJNË PARA QEVERISË F. 7

EKONOMI



KMDLNJ-ja KËRKON NGA DEPUTETËT QË TA VOTOJNË PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE F. 9

BORDET E NDËRMARRJEVE PUBLIKE, TË 'REZERVUARA' PËR BURRA F. 8

SPORT



YLLI FITON PAS VAZHDIEMEVE NDAJ VËLLAZNIMIT F. 14

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Austria sërish nën izolim të plotë

VJENË, 15 NËNTOR - Austria ka vendosur masën e izolimit mbarëkombëtar në përpjekje për të vënë nën kontroll pandeminë Covid-19. Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, u ka kërkuar austriakëve që të mos takojnë askënd jashtë shtëpisë së tyre, në një përpjekje për të frenuar një rritje të shpejtë të rasteve me

koronavirusin e ri. Ai tha se shkollat do të mbyllen dhe studentët do të mësojnë nga shtëpia duke filluar nga dita e martë, kur masat e reja do të hyjnë në fuqi. Të premten Austria raportoi një numër rekord prej 9 586 të infektuarish me Covid-19.

Kjo shifër ishte nëntë herë më e lartë se në kulmin e valës

fillestare më parë këtë vit. Vendi ka regjistruar më shumë se 191 000 raste që nga fillimi i pandemisë dhe 1 661 vdekje të lidhura me Covid-19. Deri më 6 dhjetor, sa është paraparë të zgjasin masat e reja, të gjitha dyqanet jothelbësore do të duhet të qëndrojnë të mbyllura. Të gjithë qytetarëve u është thënë, që nëse ua lejojnë

kushtet, të punojnë nga shtëpitë.

Ministri i Shëndetësisë i Austrisë, Rudolf Anschober, ka thënë se ky është shansi i fundit për ta ndaluar kolapsin e shërbimit shëndetësor. Austria kishte vendosur masën e mbarëkombëtar në mars, gjatë izolimit të saj të parë



valës së parë të pandemisë.

Trumpi jep sinjale se e ka pranuar fitoren e Bidenit

UASHINGTON, 15 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump duket se e ka pranuar për herë të parë që rivali i tij demokrat, Joe Biden, fitoi zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit. Biden u projektua fitues, tetë ditë më parë, nga të gjitha mediat kryesore të ShBA-së, pasi rezultatet jozyrtare i dhanë atij më shumë se 270 votat e Kolegjit Zgjedhor, të nevojshme për ta fituar Shtëpinë e Bardhë. Rezultatet e bëra publike gjatë javës zgjeruan epërsinë e tij në 306 me 232 të votave në Kolegjin Zgjedhor. Trump, i cili ka pretenduar fitoren disa herë, që nga përfundimi i zgjedhjeve, përsëriti pretendimet e tij, të pabazuara se votimet ishin manipuluar në favor të Bidenit. "Ai fitoi sepse zgjedhjet u

manipuluan", ka shkruar Trumpi në "Twitter" më 15 nëntor.

Trumpi dhe ekipi i tij ligjor kanë filluar një sërë sfidash përkundër faktit se zyrtarët e zgjedhjeve në të gjithë vendin kanë thënë se nuk kanë prova të parregullive serioze. Për ta siguruar rizgjedhjen, Trumpi do të duhet ta përmbysë epërsinë e Bidenit në disa shtete, një rezultat që shumica e analistëve thonë se nuk ka shumë gjasa të ndodhë. Fushata e Trumpit, megjithatë, shënoi një fitore ligjore më 14 nëntor, kur një gjykatës i Pensilvanisë urdhëroi qarqet të mos numërojnë një numër të vogël të fletëvotimeve me postë, ose të rasteve kur votuesi nuk paraqiti identifikimin e vlefshëm në



kohë. Numri i fletëve të votimit besohet të jetë disa mijëra, të cilat janë shumë pak për ta ndryshuar rezultatit në Pensilvani, ku Bideni mban një

epërsi prej rreth 55 000 votash. Gjykatat në Pensilvani dhe dy shtete të tjera, Arizona dhe Miçigan, kanë hedhur poshtë padi të tjera. Zyrtarët e lartë federalë dhe shtetërorë,

përgjegjës për sigurinë e zgjedhjeve, thanë më 12 nëntor se nuk kishte "asnjë provë" që votat në ndonjë mënyrë ishin të komprometuara ose të ndryshuara.

Përshkallëzohet situata në Etiopi

ADDIS ABABA, 15 NËNTOR - Forcat në rajonin verior Tigray të Etiopisë kanë qëlluar me raketa në aeroportet në një shtet fqinj, ndërsa konflikti i tyre me qeverinë po rritet. Fronti Çlirimtar i Popullit të Tigray (TPLF), i cili kontrollon Tigray, tha se kishte shënjestruar dy vendet në shtetin Amhara dhe paralajmëroi për sulme të mëtejshme. Tensionet midis qeverisë së Etiopisë dhe TPLF janë përshkallëzuar në përlëshje ushtarake në muajin e kaluar.

Amnesty International ka thënë gjatë javës se dhjetëra



persona janë "masakruar" në rajonin Tigray të Etiopisë dhe dëshmitarët kanë fajësuar për

këto vrasje, forcat që mbështeten nga një parti lokale që është në pushtet, që

po luftojnë me qeverinë federale. Kryeministri Abiy Ahmed ka akuzuar forcat besnike ndaj udhëheqësve të Tigray për kryerjen e vrasjeve masive, ndërsa TPLF ka mohuar përfshirjen.

Abiy urdhëroi një operacion ushtarak kundër TPLF në fillim të këtij muaji pasi ai i akuzoi ata për sulmimin e një kampi ushtarak. Që nga ajo kohë ka pasur një numër përplasjesh dhe sulmesh ajrore në rajon. Luftimet kanë detyruar të paktën 17 000 civilë ta kalojnë kufirin me Sudanin, sipas Kombeve të Bashkuara. Marrja e informacionit të

verifikuar në mënyrë të pavarur në lidhje me situatën në Tigray është e vështirë, sepse linjat telefonike dhe shërbimet e internetit janë të prishura. TPLF dominoi në jetën ushtarake dhe politike të Etiopisë për dekada me radhë para se Abiy të mernte detyrën më 2018 dhe të fillonte një program të reformave. Vitin e kaluar Abiy shpërndau koalicionin qeverisës, të përbërë nga disa parti rajonale me bazë etnike dhe i bashkoi ato në një parti të vetme, kombëtare, Partinë e Prosperitetit, por TPLF nuk pranoi të bashkohej.

Përfshihet nga flakët xhamia historike në Turqi

Stamboll, 15 nëntor - Është përfshirë nga flakët të dielën xhamia historike në Stamboll. Mediat turke shkruajnë se xhamia Vanikoy gjendet në pjesën aziatike të Stambollit. Zjarrfikësit u munduan të

parandalojnë që zjarri të arrinte në një pyll prapa xhamisë dhe shtëpitë afër saj, teksa raportohet se vetë xhamia ka marrë dëmtime të rënda.

Xhamia ka strukturë prej druri, me një minare.

Shkaku i zjarrit ende nuk është bërë i ditur. Xhamia u ndërtua më 1670 nga Vani Mehmet Efendi. Me vetëm një minare dhe një ballkon minareje, xhamia drejtkëndëshe ishte bërë kryesisht nga druri.



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur konferencë për media

Kurti kërkon nga qeveria që ta mbrojë UÇK-në në Hagë

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për media mbajtur të dielën, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për mbrojtjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ish-ushtarëve të tjerë të UÇK-së, të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale për krime lufte në Hagë. Lideri i LV-së ka bërë thirrje që për luftën çlirimtare të jenë unikë. “Ne duhet të jemi bashkë për luftën tonë çlirimtare dhe kundër Serbisë e cila nuk na njeh sepse është e papenduar për krimet e kryera”, ka thënë Kurti



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për media mbajtur të dielën, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për mbrojtjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët po akuzohen nga Gjykata Speciale për krime lufte në Hagë. “Në javën që lamë pas, në Hagë, në atë që po e quajmë Gjykatë Speciale, u paraqitën dhe thanë fjalët e tyre hyrëse ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, ish-drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçi, ish-drejtuari i Shërbimit Inteligent të UÇK-së, Kadri Veseli dhe ish-Inspektori i Përgjithshëm i UÇK-së, Rexhep Selimi. Ne kemi folur gjërë e gjatë për Gjykatën Speciale në shtatë vjetët e fundit dhe nuk ka nevojë të përsëritim këtu. Kosova ka pasur vazhdimisht gjykata speciale, njëherë UNMIK-un e Tribunalin e Hagës, pastaj EULEX-in. Edhe prokuroria e gjykatat në Kosovë përgjithësisht kanë qenë bukur speciale me pasivitetin e tyre, por kjo gjykata e fundit tash, sërish në Hagë, sigurisht se është më specialja. Jo çmimin e lirisë, por çmimin e gabimeve politike jemi duke e paguar tani”, ka thënë Kurti. Ai ka thënë se Gjykata Speciale

është e padrejtë dhe e njëanshme në raport me UÇK-në si palë dhe me etninë tonë shqiptare si përkatësi. Ngrahina e kësaj gjykate shkon kundër kujtesës sonë individuale dhe kolektive, kundër përvojës sonë njerëzore e politike. Kurti ka thënë se do të ndalet për të folur në dy elemente të rëndësishme të aktakuzës kundër Krasniqit, Thaçit, Veselit e Selimit. “Ajo çfarë pretendon prokuroria në aktakuzë është se në UÇK ka ekzistuar një grup kriminal përbrenda, me shprehjen që ia përcakton kjo prokurori si ndërmarrje e përbashkët kriminale. Pra, njëfarë strukture paralele kriminale brenda UÇK-së, thua se kemi pasur edhe UÇK edhe NPK! Edhe Ushtri Çlirimtare të Kosovës, edhe njëllonj Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale aty! Prokuroria e ka gabim. Nuk ka pasur strukturë të tillë paralele kriminale. UÇK-ja kishte Shtabin e Përgjithshëm dhe drejtoritë përkatëse, Zyrën e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik, Adem Demaçi, Zonat Operative, brigadat e batalionet e njësitë etj. që i dimë të gjithë, e jo aty tash një strukturë paralele siç pretendon prokuroria. Ky lajmi më i ri në Kosovë, për njëfarë NPK-je brenda UÇK-së, nuk është i vërtetë”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se në Hagë nuk

janë duke u përndjekur vetëm individët, por as nuk mund të mbrohen të pandehurit vetëm si individë. “Shteti i Kosovës duhet ta organizojë e ta koordinojë mbrojtjen e të pandehurve. Ata e pamë se i kanë avokatët e tyre secili, mirëpo nevojitet bashkërendim nga shteti. UÇK-ja nuk ka qenë e asnjërit, por e të gjithëve dhe që të gjithë duhet ta mbrojmë atë. Me fjalë të tjera, kjo është edhe punë qeverie, kjo është sidomos punë qeverie. Është qeveria e Kosovës ajo që duhet

të angazhohet për sintezën e përfaqësimit dhe mbrojtjes në këtë proces. Mbrojtja dhe përfaqësimi duhet të bashkërendohen e të sintetizohen. Për fat të keq në këtë kohë të vështirë, Kosova nuk ka një qeveri që mund ta bëjë këtë. Kjo qeveri e paligjshme e cila që nga fillimi varej prej secilit deputet të Listës Serbe e që tash është veçse qeveri e pakicës që po tkurret përditë, nuk mund ta mbrojë e shpëtojë as vetveten, se lëre më ndokënd tjetër. E keni parë se si shqetësimi i saj

në këtë muaj ishte eliminimi i Task Forcës Kundër Korrupsionit, e jo mbrojtja e UÇK-së në arenën ndërkombëtare e në Gjykatën Speciale”, ka deklaruar Kurti. Lideri i LV-së ka bërë thirrje që për luftën çlirimtare duhet të jenë unikë. “Ne duhet të jemi bashkë për luftën tonë çlirimtare dhe kundër Serbisë e cila nuk na njeh sepse është e papenduar për krimet e kryera. Janë bërë shumë gabime në të kaluarën në Kosovë. Nuk kemi pse të bëjmë gabime të reja”, ka thënë Kurti.



Liburn Aliu, ushtrues i detyrës i shefit të grupit parlamentar të LV-së

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Deputeti Liburn Aliu do ta ushtrijë detyrën e shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije të dielën

lideri i LV-së, Albin Kurti. “Tash e tutje grupi parlamentar i LV-së do të ketë ushtrues detyre deputetin Liburn Aliu, i cili do ta zëvendësojë kryetarin tonë të grupit parlamentar

Rexhep Selimi. Nuk do të zgjedhim kryetar të ri, nuk do të nxitohemi, e kemi kryetarin Selimi. Funkcionalisht detyrën e tij do ta kryejë Liburn Aliu”, ka thënë Kurti.



AKTAKUZAT E GJYKATËS SPECIALE KUNDËR ISH-KRERËVE TË UÇK-SË KANË NDRYSHUAR EDHE RRJEDHËN E SITUATËS POLITIKE NË KOSOVË

ZGJEDHJET E REJA, TË PASHMANGSHME

Pas zhvillimeve të fundit në Kosovë, ngritjes së aktakuzave nga Gjykata Speciale kundër ish-krerëve të UÇK-së, ka filluar të diskutohet si ide shkuarja e vendit në zgjedhje të reja parlamentare. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhjet e reja duhet të mbahen sa më parë. Edhe deputeti i PDK-së, Kujtim Gashi, ka thënë se qeveria Hoti duhet sa më parë të ikë. Të mendimit për zgjedhje të reja janë edhe analistët politikë Shkëlzen Maliqi dhe Belul Beqaj, të cilët kanë vlerësuar se zgjedhjet e reja në Kosovë janë të pashmangshme. Ata kanë theksuar se vendit i duhet një qeveri më e gjerë

zgjedhjet duhet të mbahen sa më parë, meqenëse çdo ditë e humbur është ditë e fituar për të korruptuarit dhe një ditë më pak për qytetarët e vendit tonë. Jemi të interesuar që këto zgjedhje të jenë të një ore më parë apo qysh thotë populli, qysh dje, por kjo nuk varet vetëm prej Lëvizjes Vetëvendosje e cila ka 31 deputetë, që janë të pamjaftueshëm pa të tjerët për të shkaktuar zgjedhje të reja përmes rrëzimit të kësaj qeverie”, ka thënë Kurti të dielën në një konferencë për media.

Ai ka thënë se pas zgjedhjeve të reja duhet ta kemi edhe presidentin e ri. “Ne konsiderojmë se nuk mund të ketë unitet pa legjitimitet. Presidenti ose presidentja e re duhet ta përfaqësojë unitetin e popullit dhe kjo nuk mund të bëhet në kushtet kur kemi qeveri të paligjshme. Unë nuk kam pasur takime për

çështjen e zgjedhjes së presidentit. Kosova ka ushtrues detyre të presidentit, pra nuk është e zbrazët ajo karrige edhe për së paku gjashtë muaj teorikisht në bazë të Kushtetutës sonë, por pas zgjedhjeve të reja, mund të kemi president të ri, dhe qeveria e vjetër nuk e ka as legjitimitetin, as autoritetin, as kredibilitetin për iniciativa të tilla”, ka thënë Kurti, raporton “Epoka e re”.

Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Kujtim Gashi, thënë se arroganca dhe injoranca e kësaj qeverie ka bërë që vendi ynë tash e sa kohë të mbetet pa pako ekonomike, e cila do t’i adresonte problemet me pandemi e ekonomi. Për më tepër, në vend se t’i ndihmojë bizneset, kjo qeveri ka vendosur ta mbyllë përsëri vendin. Duke parë keqmenaxhimin e situatës, deputeti Gashi ka thënë se kjo

qeveri sa më parë duhet të ikë. “Pra, është një qeveri që duhet të shkojë në shtëpi sa më herët, sepse është e paaftë për të qeverisur dhe për ta menaxhuar pandeminë dhe ndihmuar ekonominë”, ka thënë Gashi.

Për shkuarje në zgjedhje të reja ka kërcënuar edhe partia e Ramush Haradinajt, AAK-ja, nëse lideri i saj nuk zgjidhet president. “Jam ofruar si kandidat për president nëse ka vlerësim, e nëse ky vlerësim vjen, ende jemi këtu, nëse jo, pas këtyre zhvillimeve, zgjedhjet janë zgjidhja”, ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Kurse kryeministri Avdullah Hoti javën e kaluar ka komentuar zhvillimet në vend. Ai ka thënë se partitë politike duhet të ulen së bashku dhe të gjejnë zgjidhje për president ose të pajtohen për datën e zgjedhjeve të reja. “Paritë duhet të ulen bashkë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Përfaqësues të partive politike në vend dhe analistë kanë folur për mundësinë e zgjedhjeve të reja parlamentare, pas zhvillimeve të fundit, të ngritjes së aktakuzave nga Gjykata

Speciale kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Mbajtja e zgjedhjeve të reja parlamentare po shihet si mundësi e pashmangshme. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se vendi duhet të shkojë sa më parë në zgjedhje të reja. “Besojmë se





për zgjedhjen e presidentit të ri ose duhet të merren vesh për zgjedhje”, ka thënë Hoti. Edhe analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se zgjedhjet e reja në Kosovë janë të pashmangshme. Ai ka thënë se vendit i duhet një qeveri më e gjerë. “Mendoj se zgjedhjet janë të pashmangshme, por jo menjëherë dhe jo as në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, jo vetëm për shkak të pandemisë, por edhe duhet një lloj stabilizimi i brendshëm i raporteve. Koalicioni më i gjerë qeverisës do të mund të kontribuonte në këndellje, por me premtim që të mbahen zgjedhjet e reja pasi që të krijohen kushtet më të volitshme. Po kështu, një qeveri më e gjerë na duhet edhe për shkak të dialogut, të cilin nuk duhet ta lëshojmë me fajin tonë ose duke çuar inate, për arsye se ende ka një fije arsye të besohet se edhe BE-ja dëshiron që ta mbyllë dialogun me sukses dhe njohje të ndërsjellë. Duhet të jemi të kujdesshëm në kërkesat për ndërprerjen e dialogut, të paktën derisa nuk kemi një qeveri të re funksionale në ShBA”, ka thënë Maliqi për gazetën “Epoka e re”.

I pyetur se si duhet të sillen partitë politike në raport me sfidat që ka vendi, kur dihet se Gjykata Speciale ka lënë

Kosovën pa president dhe ka sjellë një përplasje të partnerëve të koalicionit qeverisës, Maliqi ka thënë se partitë politike po sillen në mënyrë krejtësisht të gabuar. “Në kohën e pandemisë partitë politike po sillen në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe pa koordinim substancial që diktohet nga interesi vital i mbrojtjes së shëndetit kombëtar dhe ekonomisë së shtetit dhe kështu po vazhdojnë edhe në raport me gjykimin në Hagë. Mirëpo, besoj se situata do t’i kthjellë shpejt, sepse nuk ka më hapësirë manovruese për konfrontimet që në plan të parë nxjerrin interesat e partive, të grupeve dhe të liderëve të caktuar, e jo ato të përgjithshme”, ka deklaruar Maliqi.

Politologu Belul Beqaj ka thënë se sjelljet e opozitës ia kanë mundësuar mbijetesën qeverisë përkundër faktit se shumica absolute e qytetarëve është e pakënaqur me qeverisje. “Unë pres që pakënaqësia e shtresuar ndër vite, që po kulmon me keqqeverisje aktuale, t’i nxisë zgjedhjet si mundësi e ndryshimit të politikëbërjes dhe politikanëve”, ka thënë Beqaj.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se e

përkrah nismën e kryeministrit Avdullah Hoti për konsultime me subjektet politike për të gjetur mënyrë për zgjedhje të presidentit të Kosovës dhe nëse nuk merren vesh atëherë të caktohet data për zgjedhje të reja. “Në rrethanat aktuale KMDLNj vlerëson se nuk ka kushte për zgjedhje të reja andaj dyshon edhe në arsyeshmërinë e mbajtjes së zgjedhjeve për kryetar komune në Podujevë dhe në Mitrovicë. KMDLNj kërkon unitet të subjekteve politike dhe jopolitike të Kosovës për tejkalimin e situatës që është shumë e rëndë dhe vetëm pastaj të bisedohet për zgjedhje eventuale. KMDLNj,

mbështetur në situatën shumë të rëndë të shkaktuar nga Covid-19, vlerëson se pas konsultimit të subjekteve politike mund të caktohet një kandidat konsensual për president të Kosovës, pa pasur nevojë të shkaktohet krizë institucionale. Në këto rrethana nuk ka kushte as për rrëzim të qeverisë e as për zgjedhje të parakohshme. Në rastin më të mirë, nëse ka marrëveshje të subjekteve politike për zgjedhje të parakohshme, ato nuk mund të mbahen para muajit qershor 2021”, ka theksuar KMDLNj në një komunikatë për media.

SAMI LUSHTAKU KËRKON NGA POLITIKANËT E SHQIPËRISË TË JENË MË AFËR KOSOVËS



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ish-komandanti i UÇK-së, Sami Lushtaku, ka kërkuar nga politikanët e Shqipërisë t’i lënë marrëzirat për akuzat për krimet e luftës. Ai ka thënë se asnjë politikan shqiptar nuk ka

ardhur në Kosovë për të qenë afër shqiptarëve të Kosovës në kohën kur Gjykata Speciale ka arrestuar figurat kryesore të UÇK-së. I ftuar në “ABC” për të folur rreth luftës çlirimtare në Kosovë dhe gjykatës së Hagës, Sami Lushtaku, ish-komandant i UÇK-së, ka komentuar edhe

akuzat që janë bërë në Shqipëri në drejtim të kreut të Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Lushtaku ka thënë se politikanët shqiptarë duhet t’i lënë pas ato që ai i quajti marrëzira dhe të jenë më aktivë dhe më pranë Kosovës në këtë kohë. “Unë mendoj se

politikanët shqiptarë duhet t’i lënë këto marrëzira dhe të jenë më aktivë dhe më afër nesh në Kosovë. Deri më tani asnjë politikan nuk ka ardhur në Kosovë që ta bashkëndiejë këtë që i ka ndodhur kryetarit të shtetit... Kam pritur që një pjesë e institucioneve të

Qeverisë së Shqipërisë të vijë në Kosovë, të takohet me ne, por deri më tani nuk ka ndodhur. Dua ta falënderoj Ervin Salijanin që ishte në Kosovë, e kam pritur unë dhe bashkë kemi shkuar te varrezat e dëshmorëve”, ka thënë Lushtaku.

I jepet lamtumira e fundit asamblistit Labinot Aliaj

ISTOG, 15 NËNTOR (ER) - Në varrezat e qytetit të Istogut të dielën i është dhënë lamtumira e fundit asamblistit të Partisë Demokratike të Kosovës, Labinot S. Aliaj (28 vjeç), i cili ndërroi jetë të shtunën. Pos familjarëve, në ceremoninë e varrimit morën pjesë përfaqësues nga Komuna e Istogut, përfaqësues të PDK-së, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe shumë qytetarë. Të dielën Kuvendi Komunal i Istogut ka mbajtur mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së Labinot Aliaj. I pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, ushtruesi i detyrës së kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, kryetari i Degës së PDK-së në Istog, Lulzim Shoshi, deputetë të PDK-së, asamblistë dhe qytetarë të shumtë.



Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Istogut, Qaush Balaj, ka thënë se Kuvendi Komunal ka humbur këshilltarin më të përkushtuar, ndërsa Istogu ka humbur aktivistin më të dalluar, "e familja ka humbur njeriun më të dashur", ka thënë ai.

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë

se Labinoti vepronte e përfaqësonte më së miri interesat e qytetarëve prej shumë kohësh. "Aktivizmi i tij qytetar e politik, puna dhe angazhimi në shërbim të njerëzve, pa dallim, ishin virtyte të Labinotit që e kanë dalluar nga gjithë të tjerët. Ishte kritik ndaj zhvillimeve negative, por edhe mbështetës i punëve të



mira. Familja, Istogu dhe PDK-ja humbën birin, qytetarin shembull e aktivistin besnik. Jeta dhe vepra e tij do të shërbejë si udhërrëfim për të gjithë ne në parti, se si duhet qyteti, Kosova dhe mbrohen interesat e qytetarëve. Dhimbjen dhe zbrazëtinë e madhe do të përpiqemi ta kompensojmë me punë e

angazhim për një Kosovë më të mirë, ashtu siç Labinoti e dëshoi dhe u angazhua", ka deklaruar Hoxhaj.

Labinot Aliaj ishte një aktivist i palodhshëm i Partisë Demokratike të Kosovës, zë i fuqishëm i qytetarëve në Asamblenë Komunale në Istog dhe, si një i ri, ishte edhe humanist i madh.

Kryetari Jashari inspekton punimet në fshatin Lubovec të Skenderajt

SKENDERAJ, 15 NËNTOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari, me bashkëpunëtorë kanë inspektuar punimet që janë duke u zhvilluar për asfaltimin e segmenteve rrugore në fshatin Lubovec. "Në kuadër të zhvillimit të projekteve infrastrukturore, për të krijuar kushte të favorshme për secilin qytetar të komunës sonë, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku si dhe drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inspektuan punimet që po bëhen për asfaltimin e segmenteve



rrugore në fshatin Lubovec. Çdo ditë punë në shërbim të qytetarëve!", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.

Asfaltohen disa rrugë në Balloc të Podujevës

Podujevë, 15 nëntor (ER) - Në kuadër të investimeve në infrastrukturën rrugore në Komunën e Podujevës është duke u realizuar projekti i asfaltimit të disa rrugëve në fshatin Balloc. Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka

vizituar Ballocin, ku ka inspektuar punimet e asfaltimit të rrugëve, me qëllim që ato të kryhen në mënyrë cilësore dhe të respektohen parametrat e paraparë sipas projektit. Gjatësia e rrugëve që janë asfaltuar në këtë fshat është 1.2 km.



Kamenica merr pamje të bukur me muralin e punuar nga artisti spanjoll

KAMENICË, 15 NËNTOR (ER) - Komuna e Kamenicës është bërë pjesë e festivalit të artit publik. Në kuadër të festivalit "Mural Fest Kosova", me drejtoreshën Lebibe Topalli, artisti nga Barcelona, Slim Safon, ka pikturuar një mural me fotografinë e fotografit Arian Mavriqi, në një ndërtesë në Kamenicë. Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, duke falënderuar të gjithë ata që janë angazhuar për këtë mural, ka thënë se Kamenicës po i shtohen edhe më shumë ngjyra. "Edhe Kamenica pjesë e festivalit të

artit publik. Kamenicës sonë po i shtohen edhe me shumë ngjyra nga murali i realizuar nga artisti Slim Safon nga Barcelona. Falënderoj drejtorin Arianit Ibrahim, drejtoreshën e 'Mural Fest Kosovo', Lebibe Topalli, që ky objekt në qytetin tonë po merr këtë pamje. Kjo foto, dhe ajo në mural, është nga Arian Mavriqi", ka thënë ai. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Arianit Ibrahim, ka thënë se aktivitetet e tilla janë të mirëseardhura në Kamenicë. "Falënderoj drejtoreshën Topalli dhe artistin Safon për

pikturimin e këtij murali. Kamenica zbukurohet çdoherë e më shumë nga aktivitetet e tilla ku shfaqen gjërat e bukura, siç është kjo fotografi e fotografit Arian Mavriqi. Do t'i vazhdojmë aktivitetet kulturore për një Kamenicë që e duan të gjithë", ka thënë ai. Ndërsa i lumtur është shprehur edhe vetë fotografi Mavriqi për pikturimin e fotografisë së tij. "Përfundimi i muralit në Kamenicë bashkë me artistë, gazetarë dhe aktivistë nga Kamenica. Faleminderit 'Mural Fest Kosova' me drejtoreshë



Lebibe Topalli! Faleminderit DKRS me drejtorin Arianit Ibrahim si dhe artistin Slim

Safon nga Barcelona e Spanjës për kontributin", ka thënë ai.

Qeveria thotë se ka rritur kapacitetet shëndetësore në përballje me Covidin

Qeveria e Kosovës ka bërë me dije të dielën se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'u përballur me pandeminë Covid-19. Në një komunikatë për media thuhet se në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në spitale rajonale është ngritur në nivelin më të lartë mobilizimi i stafit shëndetësor, janë rritur kapacitetet me shtretër, janë rritur kapacitetet për furnizim me oksigjen si dhe janë ndërmarrë veprime të tjera

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Qeveria e Kosovës përmes një komunikate për media ka njoftuar të dielën se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'u përballur me Covid-19. Qeveria ka vlerësuar se situata me Covid-19 është e rëndë, ngjashëm siç është në rajon dhe në BE. "Megjithatë, situata me Covid-19 është e rëndë, ngjashëm siç është në rajon dhe në BE. Të gjithë duhet t'i ndihmojmë mjekët dhe infermierët tanë të përballem me këtë gjendje duke respektuar masat e propozuara nga IKShP, të cilat i kanë ndërmarrë qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë. Të gjithë ata që janë prekur nga Covid-19 nuk janë vetëm në këtë situatë. Stafi shëndetësor dhe institucionet e tjera janë në mbështetje të tyre", ka njoftuar qeveria.

Sipas Qeverisë së Kosovës, bizneset dhe punëtorët që janë prekur nga kjo situatë nuk janë vetëm. "Shteti i Kosovës do t'u ndihmojë për tejkalimin e situatës, siç ka bërë duke ndihmuar bizneset, punëtorët, bujqit, gratë në biznes, komunitetet joshumicë, familjet në asistentë sociale dhe të tjerët përmes fondit për rimëkëmbje ekonomike prej 365 milionë eurosh. Do të vazhdojmë edhe në vitin e ardhshëm me fondin për

rimëkëmbje, i cili është paraparë fillimisht në shumë prej 182 milionë eurosh, por që do të rritet me burime të tjera të jashtme", ka theksuar qeveria në njoftimin për media.

Sipas këtij njoftimi, në QKUK në Prishtinë dhe në spitale rajonale është ngritur në nivelin më të lartë mobilizimi i stafit shëndetësor. "Është organizuar orari i stafit shëndetësor në përputhje me numrin e pacientëve që mund të paraqiten në spitale. Janë bërë planet operationale të klinikave në QKUK për të ofruar shërbime emergjente sipas prioriteteve, gjithashtu janë rritur kapacitetet me shtretër. Janë rritur kapacitetet për furnizim me oksigjen të lëngshëm. Është funksionalizuar Mjekësia Sportive ku janë fituar edhe 101 shtretër shtesë për pacientë me Covid-19. Janë rritur kapacitetet për respiratorë duke shfrytëzuar hapësirat e Klinikës Endokrine që afërsi të Mjekimit Intensiv Qendror", bëhet me dije në njoftimin e qeverisë.

Sipas njoftimit të Qeverisë së Kosovës, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik po bën një punë kolosale. "Janë rritur testimet në mbi 2 000 në ditë dhe pothuajse kushdo që ka nevojë arrin të testohet brenda ditës (nga muaji shkurt e deri më tani janë 122 mijë qytetarë, prej të cilëve 116 mijë janë testuar nga data 4 qershor e deri më sot). Po bëhet gjurmimi i

rasteve dhe është ndërtuar sistemi i hetimit epidemiologjik, që na mundëson parashikimin e zhvillimit të epidemisë dhe rrjedhimisht marrjen e masave të nevojshme me kohë. Po mbikëqyren vazhdimisht shkollat duke testuar nxënësit dhe arsimtarët dhe duke marrë vendimet e nevojshme për secilin rast. Po mbikëqyren kontaktet me ekipet në terren. Gjithashtu, po përgatitet analiza ditore e gjendjes

në terren që ndihmon institucionet shëndetësore të marrin veprimet e nevojshme", ka njoftuar qeveria.

Po ashtu, është bërë me dije se Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera të përfshira në menaxhimin e situatës me Covid-19, është duke mbështetur dhe koordinuar punën e të gjitha institucioneve shëndetësore. "Po koordinon punën me partnerët

ndërkombëtarë për mbështetjen që po e marrim me donacione dhe me këshilla. Po punon për sigurimin e vaksinës krahas vendeve të BE-së. Po koordinon veprimet me shtabet e komunave në veçanti në fushën e arsimit. Inspektoratet dhe policia po punojnë ngushtë me komuna dhe institucione të tjera për ta mbikëqyrë zbatimin e masave, duke punuar me orar të zgjatur", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Kosova shënon edhe 13 viktima dhe 501 raste të reja me Covid

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar edhe 501 raste të reja me Covid-19. Rezultatet janë në bazë të 1 361 mostrave të testuara. Sipas IKShPK-së, nga Covid-19 kanë vdekur edhe 13 pacientë. "Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren tri raste (76, 70, 70 vjeç), Dragash një (42

vjeç), Drenas një (61 vjeç), Gjakovë një (83 vjeç), Gjiilan një (77 vjeç), Kamenicë një (80 vjeç), Pejë një (81 vjeç), Podujevë një (68 vjeç), Prishtinë një (74 vjeç), Suharekë një (75 vjeç), Vushtrri një (75 vjeç)", bëhet me dije në njoftimin e IKShPK-së. Sipas të dhënave, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 250 pacientë, ndërsa numri i

rasteve aktive është 10 990. Që nga fillimi i pandemisë më 13 mars të këtij viti, në Kosovë janë infektuar 29 117 persona, prej të cilëve 17 305 janë shëruar ndërsa 822 kanë vdekur. Në ditët e fundit ka pasur një rritje të numrit të të infektuarve, duke detyruar autoritetet të vendosin masa kufizimi në lëvizje në disa komuna të vendit.

Punëtorët e Telekomit sot protestojnë para qeverisë



PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Punëtorët e Telekomit sot (e hënë), në orën 13:00, do të protestojnë në sheshin "Skënderbeu". Më 26 tetor, për herën e dytë, Telekomit të Kosovës i janë bllokuar llogaritë bankare nga "Dardafon.net" (ish-"Zmobile") për shkak të borxhit ndaj kësaj kompanie. "Me datën 26.10.2020, për herën e dytë, Telekomit të Kosovës, nga zhvatesit - 'Devollët' - i janë bllokuar llogaritë bankare. Bllokimi i dytë brenda tre muajve dhe tërheqja e mjeteve financiare ka rrezikuar operimin e

kompanisë dhe mirëqenien e punëtorëve. Prej datës 26.10.2020 e deri me tani, FSP-PTK ka bërë përpjekje për zgjidhjen e kësaj gjendje përmes dialogut social, mirëpo aksionarit (Qeverisë të Republikës së Kosovës) nuk i kanë marrë parasysh kërkesat tona për një zgjidhje emergjente, që çon në ruajtjen e kompanisë, punëtorëve dhe rendit publike në Kosovë. Ju kemi treguar se: kompania 'Dardafon.net' (ish-'Zmobile') ka qenë dhe është kontratë kriminale, e cila Telekomit i ka shkaktuar humbje mbi 200 milionë euro. Gjithashtu, kemi

bërë të qartë se FSP-PTK nuk e njeh këtë borxh por, kot...!", ka njoftuar Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së (FSP-PTK). FSP-PTK këtë gjendje e ka cilësuar "alarm i kuq" pasi, sipas tyre, në çdo moment janë duke u rrezikuar mbi 1 milion konsumatorë të Telekomit, pagat e punëtorëve dhe në fund humbja e vendeve të punës. "Prandaj, ne si punëtorë nuk kemi rrugëdalje tjetër, vetëm të protestojmë, protestojmë dhe protestojmë, përkundër masave që ka ndërmarre qeveria për ruajtjen nga Covid-19", është theksuar në njoftimin e FSP-PTK.

Bordet e ndërmarrjeve publike, të “rezervuara” për burra

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Bordet e ndërmarrjeve publike në shumicën e rasteve udhëhiqen nga burrat dhe kriter për emërim në këto borde nuk është kualifikimi, por librezja e partisë, thotë Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë në organizatën joqeveritare “Fol”. Ajo thotë se në Kosovë është bërë “traditë” që këto pozita të udhëhiqen nga burrat. Kjo vërehet edhe në disa lista të kandidatëve të thirrur për intervistim, të publikuara në faqen zyrtare të Qeverisë së Kosovës. Në listën e kandidatëve të thirrur për intervistë me gojë për Bordin e Drejtorëve “Infrakos” janë gjithsej 51 kandidatë, kurse vetëm katër janë gra.

Qeveria në këtë ndërmarrje në fund të muajit tetor ka emëruar bordin e përkohshëm në këtë kompani në përbërje katër anëtarë, vetëm një është gra. Kurse për drejtor në Bordin e Korporatës Energjetike të Kosovës, në listën e kandidatëve të përzgjedhur, të publikuar më 06.10.2020, janë gjithsej 72 kandidatë, prej tyre shtatë gra. Në Bordin e Përkohshëm të kësaj korporate në fund të muajit tetor qeveria ka emëruar tre burra dhe një gra.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë qeverisës i ndërmarrjeve publike. Bordet përbëhen nga pesë ose shtatë anëtarë, të cilët përzgjidhen nga aksionarët, e që mund të jenë qeveria apo komunitat. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, qeveria është e autorizuar që të emërojë Bord të Përkohshëm të Drejtorëve për secilën ndërmarrje publike, për një periudhë gjashtëmuajore.

Më pas, emërimi i anëtarëve të bordit me mandat të plotë, për disa ndërmarrje duhet të kalojë



përmes votave të deputetëve në Kuvendin e Kosovës.

Sipas Ligjit, procesi i emërimit të anëtarëve të bordit duhet të kryhet në procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritës.

Ndërmarrjet publike në Kosovë kryejnë shërbime të rëndësishme për qytetarë si: furnizimi me ujë, mbledhja e mbeturinave, prodhimi i energjisë elektrike, transporti etj.

Demolli-Nimani: Kriter për anëtar të bordit, librezja partiake

Mexhide Demolli-Nimani, nga organizata joqeveritare Lëvizja “Fol”, thotë se gjatë monitorimit të konkurseve dhe thirrjes së

kandidatëve për intervistë, më shumë se 90 për qind kanë qenë burra. “Mendësia gjatë këtyre viteve ndoshta i ka demotivuar edhe gratë që të aplikojnë në këto pozita. Nuk do të thotë se nuk ka gra të përgatitura profesionalisht në fusha të caktuara, mirëpo duke ditur se në Kosovë duhet të kesh një librezë të partisë, apo të jesh e afërt në një parti politike që të kesh një vend pune në këto ndërmarrje, bën që shumë gra mos të hyjnë fare në garë”, ka theksuar Demolli-Nimani.

Kjo çështje gjatë këtij viti është ngritur edhe në Kuvendin e Kosovës nga Grupi Joformal i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës, thotë Arbërie Nagavci, nënkryetare e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Blerta Deliu, deputete nga Partia

Demokratike e Kosovës.

Gratë deputete në Kuvendin e Kosovës, pavarësisht përkatësisë së tyre politike, në vitin 2005 kanë krijuar Grupin Joformal të Grave me qëllim që ta monitorojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, por edhe fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe politikë. Arbërie Nagavci tregon se tashmë në Kuvend personat që konkurrojnë për këto pozita, votohen në dy lista të ndara, gra dhe burra. “Ajo që tashmë jemi duke bërë në legjislaturën e fundit, është se po hedhim në votim në lista të ndara, veç burrat dhe veç gratë. Në mënyrë që të sigurohemi që gjithsesi të kemi gra përfaqësuese më shumë në borde të rëndësishme në ndërmarrje edhe në agjenci”, ka theksuar Nagavci.

Blerta Deliu thotë se është

kërkuar që të ketë kuota gjinore edhe në përfaqësimin e grave në ndërmarrje publike. “Është vendosur që në bordet e ndërmarrjeve publike dhe shoqëri aksionare të ketë një kuota gjinore, duke parë se një numër i vogël i grave konkurrojnë apo iu nënshtrohen fazave të rekrutimit në parlament për t’u zgjedhur në bordet e ndërmarrjeve publike. Edhe aty është bërë një progres”, është shprehur Deliu.

Të dhëna zyrtare se sa është numri i grave në borde e ndërmarrjeve publike nuk ekzistojnë por, sipas një hulumtimi të Institutit GAP, të publikuar në vitin 2017, thuhet se nga 159 anëtarë të bordeve në 31 ndërmarrje publike në Kosovë, 135 kanë qenë burra dhe 24 gra.

Emërimi i anëtarëve në bordet e ndërmarrjeve publike në Kosovë është një ndër proceset që vazhdimisht është kritikuar nga shoqëria civile në Kosovë, por edhe nga faktori ndërkombëtar. Tashmë është bërë praktikë që secila parti apo secili koalicion që vjen në pushtet, t’i emërojë anëtarët e partive politike në bordet e ndërmarrjeve publike. Madje, sipas shoqërisë civile, ndarja e posteve bëhet qysh në kohën e arritjes së marrëveshjeve të partive politike për koalicion qeverisëse.

Ndryshe, vendet më të preferuara për punësim në Kosovë vazhdojnë të mbesin bordet e ndërmarrjeve publike për shkak të vlerës së lartë të pagave dhe përfitimeve të tjera. Në çdo konkurs numri i aplikuesve është shumë i madh, por në shumicën e rasteve, sipas Lëvizjes Fol, nuk është marrë për bazë kriteri profesional, por përkatësia partiake.

ATK-ja sqarim për bizneset: Certifikata e të punësuarit shkarkohet përmes Sistemit Elektronik EDI

PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka treguar se si mund të pajisen me dokument në formë leje për qarkullim pas masave të marra nga qeveria Hoti. “Referuar vendimit të Qeverisë së Kosovës, datë 13.11.2020, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse në Kosovë, Administrata Tatimore e Kosovës ju njofton se të gjitha bizneset (punonjësve të të cilave u kërkohet leje qarkullimi vetëm në kuadër të kryerjes së detyrave të punës) sipas kodeve të lejuara nga Ministria e Tregtisë dhe

Industrië, përmes Sistemit Elektronik EDI mund të pajisen me ‘Certifikatën e të punësuarit’, ka njoftuar ATK-ja. Sipas njoftimit të ATK-së, shkarkimi i “Certifikatës për të punësuarit” përmes Sistemit Elektronik EDI do t’u mundësohet vetëm shoqërive tregtare të cilat janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe kodin e veprimtarisë primare ose sekondare e kanë të lejuar sipas MTI-së. “Dokumentin ‘Certifikatë e të punësuarit’ mund të shkarkohet përmes Sistemit

Elektronik EDI, në menynë ‘Shërbimet’, nënmenynë ‘Certifikatë e të punësuarit’. Ky dokument duhet të shkarkohet për secilin të punësuar nga i cili kërkohet të lëvizë për kryerjen e detyrave të punës. Dokumentin e shkarkuar, më pastaj duhet ta vulosni dhe nënshkruani dhe, si i tillë, bashkë me letërnjoftimin dhe ID-në zyrtare (kartelën identifikuese) të punonjësit (nëse ka), do të shërbejë si leje për të qarkulluar dhe atë vetëm në kuadër të kryerjes së detyrave të punës. Pra, ky dokument për arsye tjetër nuk mund të përdoret”, ka njoftuar ATK-ja.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo	
Qeveria - Vlada - Government	
Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers	
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo	
Versioni: 17-04-2020	
CERTIFIKATË E TË PUNËSUARIT	
SubarektaOnline	
Të dhënat e tatimpaguesit	
NUI / NRF	
Emri i tatimpaguesit	
Adresa e tatimpaguesit	Shiroke rr. Brigada 123, p.n.
Nace kodi - Aktiviteti	
Pronari / Menaxheri	Telefoni

KMDLNj kërkon nga deputetët që ta votojnë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë me dije të dielën se nëse nuk votohet Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike do të falimentojë shumica e bizneseve në vend. KMDLNj ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që me propozim të qeverisë duhet ta ndryshojnë Ligjin për Trustin në mënyrë që të krijojë kushte dhe mundësi që qytetarët t'i marrin kursimet e tyre jetësore e jo për to të vendosë Trusti

seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, ku pritej të diskutohej në lexim të dytë Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike.

Çfarë parasheh Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike?

Qëllimi i këtij Projektligji është plotësimi dhe ndryshimi i disa ligjeve me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Në këtë Projektligj thuhet se "Fondi Kreditor Garantues i Kosovës (FKGK) autorizohet të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës nga 50 deri në 80 për qind".

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm, që u lëshon garanci institucioneve financiare për ta mbuluar rrezikun për kreditë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, kontributpaguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Tërheqja e këtyre mjeteve nuk është përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sipas të cilit, "kjo zvogëlon pensionet e ardhshme".

Më pas mjetet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore mund të përdoren për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me qëllim të realizimit të rimëkëmbjes ekonomike, përjashtuar kategorinë e pagave dhe shtesave. Po ashtu, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, Ministria e Financave mund ta shtyjë afatin e pagesës së tatimeve deri në dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kriteret për shtyrjen e afateve përcaktohen nga Ministria e Financave në Qeverinë e Kosovës.

Për bizneset që nuk arrijnë ta bëjnë pagesën e deklaratës tatimore nuk shqiptohet ndonjë ndëshkim, me kusht që pagesa bëhet në tremujorin e parë të vitit 2021. Ky projektligj, nëse votohet në Kuvendin e Kosovës edhe në leximin e dytë dhe shndërrohet në ligj, do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021. Pas kësaj date, të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka ripërsëritur kërkesën drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që ta votojnë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike në mënyrë që ta zbusin gjendjen tejet të rëndë të bizneseve në Kosovë.

Sipas KMDLNj-së, nëse ky projektligj nuk votohet do të falimentojë shumica e bizneseve. "Dhjetëra mijëra vende të punës do të mbyllen dhe do të varfërohet shumica e qytetarëve të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës me mosvotimin e këtij projektligji do të bartin përgjegjësi për qytetarët e Kosovës që po vuajnë nga


varfëria dhe pasiguria shkakuar nga humbjeve të vendeve të punës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, deputetët e Kuvendit të Kosovës mund edhe të mos pajtohen me buxhetin e propozuar, por duhet ta kenë të qartë se buxheti i Kosovës në rrethana aktuale nuk është buxhet zhvillimor, por i mbijetesës.

KMDLNj ka bërë thirrje që të ndryshohet edhe Ligji për Trustin. "KMDLNj, edhe në bazë të kërkesave të shumë qytetarëve, edhe më herët, por edhe tani, kërkon që paratë e kursyera duhet të shfrytëzohen sipas vullnetit dhe nevojave që i kanë qytetarët e jo që Trusti të vendosë se sa para mund të tërheqin. Deputetët e Kuvendit të Kosovës me propozim të qeverisë duhet ta ndryshojë Ligjin për Trustin dhe të

krijojnë kushte dhe mundësi që qytetarët t'i marrin kursimet e tyre jetësore e jo që për to të vendosë Trusti. Këtu nuk mund të diskutohet as shuma 10 për qind e as 30 për qind, por se qytetari merr vendim për shumën që i duhet sikur në të gjitha vendet e tjera. Duhet të bëhet e qartë se këto para nuk janë të Trustit, por të qytetarëve. Ndryshimi i Ligjit për Trustin duhet të bëhet shpejt. Në rrethana të një emergjence ekonomike të shkaktuar nga pandemia, paratë e Trustit do t'i ndihmonin shumë qytetarët ta përballojnë këtë gjendje", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Ky projektligj, pas gjashtë dështimesh për miratim në Kuvendin e Kosovës, ka arritur të miratohet në lexim të parë më 13 korrik, por javën e kaluar ka dështuar të mbahet

ATËHERË, KUSH I VRAU SHQIPTARËT NË KOSOVË?! A I ËSHTË DHËNË DICK MARTIT 'RAPORTI' I TIJ NGA MILAN ST. PROTIÇ NË ZYRAT E AMBASADËS SË SERBISË NË ZVICËR?



Nga Bedri ISLAMI

Do të ishte e vështirë për cilëndo prokurori, qoftë ajo edhe serbe, që në një aktakuzë, ngritur nga Prokurori i Specializuar për hetimin e krimeve të supozuara gjatë luftës në Kosovë, të kishte kaq shumë qëndrime të skajshme, të cilat shumëkujt në Kosovë e jo vetëm aty, edhe shumë përtej kufirit të Kosovës, do t'u zgjonte ndjenjën se e gjithë kjo është një përsiatje e akuzave të ngritura shumë vite më parë nga gjykatat e instaluar serbe në Prishtinë.

Në fakt, gjithçka është kronikë e një akti të paralajmëruar jo vetëm tre muaj më parë, kur prokurori i specializuar, pikërisht në një çast të veçantë, bëri publike aktakuzën e parë të tij, por shumë më herët, që kur lufta çlirimtare u përball njëherësh me dy materiale të paraqitura nga dy figura të njohura, Karla del Ponte përmes një libri të saj dhe bashkëvendësi i saj, Dick Marty, përmes një materiali, i cili më pas u saktësua se ishte përgatitur nga strukturat e veçanta të shtetit serb.

Themelimit të Gjykatës Speciale i ka paraprirë raportin që mban emrin e politikanit zviceran, Dick Marty e që, në fakt, është një sateshë e shërbimit të fshehtë serb, të cilin ai e ka pranuar përmes ambasadorit të Serbisë në Zvicër, Milan St. Protiç.

Karla del Ponte, një emër i njohur i jurisprudencës zvicerane, prokurore e përgjithshme e këtij shteti, që më pas u emërua edhe si kryeprokurore e Gjykatës së Hagës për krimet e luftës në Jugosllavi, ishte e njohur që në fillimet e luftës së armatosur në Kosovë si një zë i ndjeshëm kundër asaj që po ndodhte, duke qenë gjithnjë një mbështetëse e agresionit dhe kundërshtarë e rezistencës.

Pasi dështoi në dy hetimet më të mëdha të saj, në proceset kundër Haradinajt dhe bashkëluftëtarëve

të tij, dhe më pas, kundër Fatmir Limajt dhe bashkëluftëtarëve të tij, dhe dështimi ishte i përsëritur, jo rastësisht dhe jo pa pasur materiale shtesë nga agresorët, në librin e saj hapi për herë të parë, çka nuk ishte dëgjuar asnjëherë më parë, çështjen e Shtëpisë së Verdhë në rrethinat e Matit ku, sipas saj, ishin bërë krime monstruoze, ishin torturuar robër lufte, shumica serbe, atyre u ishin marrë organet jetësore, të cilat ishin shitur diku, jashtë Shqipërisë.

Akuza ishte monstruoze, por duke e ditur se reputacioni i saj tashmë ishte drejt fundit, loja u hap përmes një figure politike të kohës, që me të njëjtën gjuhë, të njëjtat fraza, deri në identike dhe burime të njëjlojtë, ngriti të njëjtat akuza, duke i shtuar shtëpisë së verdhë, që ishte larg Tiranës, edhe një shtëpi tjetër, diku në Fushë-Krujë, afër aeroportit, për t'i bërë gjërat më të besueshme.

Raporti i tij pushtoi gjithë mediat. Ishte një raport i ngritur pikërisht për ta pasur jehonën e tij dhe, mbi të gjitha, për të shkaktuar, ashtu si edhe e shkaktoi, kalimin e vëmendjes nga vrasësit të viktimat. Megjithatë Komisarati i Lartë kishte vërejtur më parë mijëra vrasje të shqiptarëve të Kosovës, apo edhe akte të tjera çnjerëzore, se "Kufomat e shqiptarëve të Kosovës të pushkatuar ishin varrosur nga civilët (ndonjëherë me kërkesë të shprehur të autorëve), nga ushtarë të UÇK-së, ose ishin marrë nga forcat serbe.

Në raste të tjera forcat serbe ishin kthyer në vendin e masakrave, kishin nxjerrë nga toka trupat e varrosur më parë në fshehtësi nga civilët dhe i kishin marrë ato. Shumë refugjatë kishin deklaruar se kishin parë traktorë ose kamionë të ngarkuar me grumbuj kufomash, të drejtuar nga policia serbe në destinacione të panjohura.

Komisariati i Lartë ka mbledhur dëshmitë dhe prova dhe ka konstatuar që kufomat ishin djegur qëllimisht, ndërsa në raste të ndryshme forcat serbe janë parë duke gërmuar varre masive. Kjo, si duket, ishte harruar, pasi bota, në atë dhjetëvjetësh, ishte mësuar me krimet e ushtrisë, policisë, forcave paraushtarake

dhe grupeve të armatosura të Arkanit apo të Sheshelit dhe vrasjet masive të tyre. Lëvizja politike serbe, fillimisht përmes Karla del Ponte e më pas përmes Dick Martyt, kishte jehonën e saj dhe kishte ardhur në një kohë kur presioni i bashkësisë ndërkombëtare për njohjen e Kosovës mbi qeverinë serbe po bëhej gjithnjë e më i qëndrueshëm për të nisur bashkëbisedime të reja.

Kosova për pesë vjet rresht është mbajtur në bankë të të akuzuarave, pasi mbi UÇK-në rëndonin dyshime për krime më të tmerrshme të dëguara ndonjëherë. Ky efekt vazhdon të rëndojë shtetin e ri të Kosovës, pasi akoma asnjë gjykatë nuk ka treguar se ato akuza ishin thjesht një fabrikim

Tani jemi në një fazë të re. Kosova ngriti Gjykatën e Specializuar, e njohur si Gjykata Speciale, e vendosi në ligjin e saj themelart, në Kushtetutë dhe, si nuk mund të ishte pritur, ata që e mbështetën më shumë vendosjen e saj do të ishin pikërisht edhe të hetuarit e parë dhe, tashmë, të akuzuarit dhe të ndaluarit e parë.

Pesë vjet e gjysmë më parë, pikërisht kur diskutohej rreth vendosjes së kësaj gjykate, kam qenë në Kosovë. Si shumë të tjerë isha i interesuar të di mendimin e mjaft prej miqve të mi, mes tyre edhe mendimin e z. Thaçi, të z. Veseli dhe z. Haradinaj.

Atëherë kur mendoja se në mendimin e tyre do të kishte dyshime, hezitim apo stepje, ata ishin bërë më të vendosur që Kosovës i duhet kjo gjykatë. Akuza e bërë nga Dick Marty kishte kaluar në Këshillin e Evropës dhe gjithçka ishte mes dy udhëve: pranimi i Gjykatës ishte pranimi i pafajësisë dhe hedhja poshtë e akuzave, ndërsa mohimi i saj, që mund të bëhej më pas nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, do të ishte pranimi i fajësisë. Koha për të bërë gjëra ndryshe, si duket, kishte shkuar dhe brohoritja e fitores, duke harruar fqinjët, kishte sjellë këto pasoja. Gjenocidi i ndodhur në Kosovë ende nuk ishte denoncuar, faktimi i asaj që kishte ndodhur ishte bërë, por mbahej i mbyllur nëpër dosje e dikasterë, ende nuk kishte dhe si duket gjatë nuk do të

ketë, një mendim të përbashkët politik.

Tani, katër ndër figurat kryesore të njohura të luftës ndodhen në Hagë, në pritje të ballafaqimit të tyre me akuzat e ngritura, të cilat, si nuk është pritur, nuk kanë të bëjnë me atë çfarë kanë bërë vetë të akuzuarit e të ndaluarit, por më shumë me rrjedhën e një zinxhiri komandues, që mban përgjegjësi për gjithçka që ka ndodhur.

Në luftë, të katërt, duan apo nuk duan të tjerët, ishin figurat më të njohura. Në aktakuzë janë ngritur aq shumë gjëra, sa që në vëmendjen e parë të krijohet mendimi i një batërdie, sikur në atë luftë nuk ka pasur asgjë tjetër, veçse përlëshje mes shqiptarëve dhe serbët ishin engjëllorë, sikur lufta për pushtet i ka nxjerrë njerëzit të luftojnë dhe duhet ditur, serbët luftën e marrin shumë seriozisht dhe shumë të egërsuar; sikur përplasjet kanë qenë mes një force politike dhe ushtarake, UÇK-së dhe gjithë të tjerëve.

Kjo është pamja e parë që të del para vetes, sa është e vërtetë kjo, është pohuar dy herë në dy gjykime nga një tribunal më i lartë se sa ky, nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, dhe të dy herët të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm.

Në aktakuzën e paraqitur tani së fundmi mungon ajo ishte fillimi i gjithë kësaj historie: Shtëpia e Verdhë. Aq më tepër një banesë e padefinuar në Fushë-Krujë.

Ka ekzistuar apo jo Shtëpia e Verdhë ashtu si përshkruhet në librin e del Pontes dhe në materialin e Dick Martyt? Janë bërë aty heqje dhe trafikime organesh, gjë e cila u përhap në aq shumë media botërore?

Vetëm ata që janë krejt të paditur mund të kishin menduar se operacione të një vështirësie të jashtëzakonshme, të pamundura shpesh herë edhe në klinika speciale, mund të bëheshin në shtëpinë dykatëshe të një fshati të panjohur apo në një banesë, diku në Fushë-Krujë.

Një mendje e çoroditur çoroditi gjithë botën dhe pasi lau duart, u mbyll në botën e tij. Cili ishte shpërblimi për këtë, askush nuk e di, e as nuk dua të paragjykoj, megjithatë një ditë gjithçka do të jetë e qartësuar. Kur politologu i njohur Bardhyl Mahmuti, autori i

librit "Mashtrimi i madh" e ftoi atë në një ballafaqim publik rreth mashtrimeve që kishte sjellë në materialin e tij, ai u largua dhe refuzoi. Misioni i tij kishte mbaruar.

Një çështje e ngritur nga një e dhënë e tillë, tronditëse dhe e sajuar, duhet të ketë një përgjigje: nëse nuk ka ndodhur dhe në fakt nuk kishte se si të ndodhte, kush e ngriti akuzën, mbi cilën bazë, cilat të dhëna, për të shkruar më tej, nëse edhe të dhënat e tjera janë ngritur mbi baza fabrikimi, dyshimi, stepje apo përfitimi?

Përgjigja e parë që pritët nga Gjykata e Specializuar dhe prokurori i saj është pikërisht në themelin e përgjigjeve të tjera: kush e fabrikoj çështjen e Shtëpisë së Verdhë?

Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, i cili në kohën e akuzave ishte në grupin hetues të UNMIK-ut në Kosovë dhe që ka vizituar pikërisht Shtëpinë e Verdhë, ka pohuar se asnjë fakt nuk është gjetur dhe asgjë e ngritur në materialin e Dick Martyt nuk ka ekzistuar.

Ka një përdallim të veçantë në cilësimin e asaj që ka ndodhur në Kosovë dhe pas luftës. Në aktakuzë, shumë herë, masakrat e ndodhura në Kosovë, të cilat u bënë të zakonshme, sidomos pas fillimit të aksionit të NATO-s, quhen si sulme, ndërsa mbrojtja e zhvilluar nga forcat e UÇK-së si veprime terroriste.

"Sulmet" serbe, që në fakt ishin masakra të organizuara, lanë pas vetes dhjetëra e qindra të vrarë. Cilësimi i thjeshtë "sulme" ul përshkallëzimin e së vërtetës, e minimizon atë, e përcakton si një gjë e zakonshme dhe bjerr të vërtetën.

"Sulmet" e forcave serbe nuk kanë qenë vetëm mbi bazat e UÇK-së, roli i saj është njohur në kohën e duhur nga të gjitha kancelaritë ndërkombëtare dhe është mbështetur në veprimet e saj. "Sulmet" serbe kanë qenë mbi këdo dhe mbi gjithkund.

Kur gjërat ishin në njohura dhe gjaku ende i pafshirë, në Raportin e Komisarit të Lartë të OKB-së, 27 shtator 1999, tre muaj pas përfundimit të luftës, shkruhej se "Në Ferizaj, policia synonte intelektualët shqiptarë, kryesisht udhëheqësit e sindikatave,

gazetarët, anëtarët e shquar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe aktivistë të mbrojtjes të të drejtave civile...".

Zyra e LDK-së, ajo e organizatës joqeveritare "Nënë Tereza" dhe zyra e mëparshme e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) u hodhën në erë. Në fund të marsit disa nga lagjet e Ferizajt u bombarduan nga forcat e rregullta të ushtrisë jugosllave (VJ), ndërsa trupat ushtarake serbe kryen kërkime në një pjesë tjetër të qytetit, duke dëbuar njerëzit dhe më pas duke iu vënë zjarrin shtëpive të tyre.

Më tej, në të njëjtin raport: Sipas disa burimeve dhe zbulimeve të tmerrshme të bëra nga forca ndërkombëtare e sigurisë në Kosovë (KFOR) dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pas kthimit në Kosovë, deri në 10 000 shqiptarë të Kosovës vdiqën gjatë fushatës së NATO-s dhe disa mijëra të tjerë rezultojnë të zhdukur. Shumica e refugjatëve të intervistuar nga OHCHR treguan se kishin qenë dëshmitarë në të paktën një incident, ku një ose më shumë individë kanë humbur jetën nga vdekje të dhunshme.

Besoj se secili e di se këtu nuk është fjala për "sulme" serbe, por për masakra të organizuara, fuqishëm të organizuara, vrasje masive dhe djegie masive.

Gjykata Speciale nuk i merr parasysh vrasjet e mbi trembëdhjetë mijë shqiptarëve, të cilat nuk bëhen përmes "sulmeve" sporadike, por masakrave të organizuara; dhunimet seksuale të mbi njëzet mijë femrave shqiptare, spastrimin etnik të Kosovës me dëbimin e shumicës dërmuese të shqiptarëve dhe asgjësimin e dokumenteve të identifikimit; shkatërrimin e 100.589 shtëpive, të 88.101 objekteve përcjellëse, të 358 shkollave, të 30 shtëpive kulturore, të monumenteve historike, të 93 bibliotekave, të 123 institucioneve shëndetësore dhe të 220 objekteve të kultit fetar (xhami, teqe, tyrbe dhe kisha katolike).

Me një fjalë Gjykata Speciale duhet të ketë parasysh gjenocidin që forcat serbe kanë ushtruar në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, dhe se fjala nuk ka qenë asnjëherë për sulme.

Ajo duhet të ketë parasysh se shumë nga këto krime u bënë nga forca paraushtarake, të cilat, si vëren Raporti i Komisionarit të Lartë të OKB-së, shpesh herë ishin fqinjët e shqiptarëve ose nga fshatra fqinj dhe që ushtruan dhunë, presion, bënë vrasje dhe u bënë pjesë e dëbimit të fqinjëve të tyre.

Lufta në Kosovë ishte një proces i imponuar dhe jo i dëshiruar. Cilësimi i UÇK-së si njësi terroriste është bërë nga institucione të tjera, jashtë Kosovës, me të cilat nuk duam të krahasojmë Gjykatën Speciale, që është pjesë e Kosovës, i nënshtrohet Kushtetutës së saj dhe, për të qenë thellësisht e

besueshme, çka deri tani nuk ngjan, duhet të njohë të vërtetën. Duhet të dijë se Kuvendi i Kosovës që miratoi ngritjen e kësaj gjykate ka njohur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si pjesë e vyer e jetës së saj dhe domosdoshmëri historike; Kuvendi ka denoncuar çdo tentim për të denigruar luftën e drejtë, të domosdoshme dhe të imponuar, ashtu si ka cilësuar atë që ka ndodhur në Kosovë si gjenocid i pushtetit serb mbi shqiptarët e Kosovës.

Në UÇK ka pasur luftëtarë nga të gjitha forcat politike. Ajo nuk është ngritur për të luftuar kundër popullit që i takon, si cilësohet gabueshëm në aktakuzën e paraqitur. Nuk ka pasur asnjë rast që luftëtarët e UÇK-së të kenë ngritur dorën kundër njerëzve të zakonshëm, pavarësisht etnisë së tyre.

Në majin e vitit 1998, njëri ndër figurat më emblematike të UÇK-së, Fehmi Lladrovci, në pyetjen e gazetarit të "BBC"-së për fajësimin e Beogradit se UÇK-ja po vret e keqtrajton banorët serbë, i është përgjigjur se "le të tregojnë një rast të vetëm, vetëm një rast, por nuk ka ndodhur e nuk do të ndodhë. Armët nuk i kemi marrë me luftue popullsinë serbe, ata janë viktimat të regjimit të Millosheviqit, por për të luftuar makinerinë ushtarake serbe".

Politika serbe nuk kishte asnjë rast në majin e vitit 1998 dhe, në ditët e Rambujesë paraqiti ankesë tek një organizatë joqeveritare për pesë të humbur a të zhdukur, nga të cilët, më pas, tre dolën gjallë e jetonin në shtetin serb. Në aktakuzë, krimet e pretenduara të UÇK-së nuk konsiderohen si raste të izoluara e sporadike, apo si krime të individëve të caktuar, por konsiderohen si (citoj): "pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të drejtuar ndaj Kundërshtarëve" (pika 17 e aktakuzës).

Sa është e vërtetë jo, një kohë e ardhshme do e saktësoj edhe më qartësisht. Por, edhe e tashmja e ka të dhënë e saj. Është e

pamundur që një luftë çlirimtare dhe në Kosovë ka pasur luftë e jo konflikt të armatosur, sikur po zihen dy barinj në mal, të mos ketë kundërshtarët e saj.

Kjo është e natyrshme, por në Kosovë, ndryshe nga sa mund të jetë menduar, ata kanë qenë shumë të paktë, pasi, të gjithë, edhe ata që ndiqnin rrugën paqësore, edhe ata të rezistencës së armatosur, kishin kaluar në të njëjtat vuajtje dhe kishin përballuar të këqija të përbashkëta.

Në Kosovë, po të ishte e vërtetë aktakuza, do të kishim pasur luftë civile, përplasje me armë, pasoja të pallogaritshme, por e vërteta është se asgjë nuk ndodhi. Megjithëse kishte dy formacione të armatosura, UÇK dhe FARK, pavarësisht dallimeve, nuk ka pasur përplasje me armë mes tyre. Përcaktimi i shtabit drejtues të UÇK-së ka qenë i saktë, i duhur dhe i vendosur: do të luftohet kundër pushtuesit serb për Kosovën e pavarur.

Nëse në raste të veçanta, sidomos pas masakrave të tmerrshme (cilësim i Komisarit të Lartë të OKB-së) ka pasur raste të veçanta të dhunës apo ndëshkimit nga pjesëtarë të UÇK-së, kjo nuk ka të bëjë me të vërtetën se, UÇK-ja ishte, ashtu si e cilësoi shkrimtari i shquar, Ismail Kadare "dalëzotëse e popullit të Kosovës".

Atëherë, kush i vrau shqiptarët në Kosovë?

Sipas aktakuzës, Kosova dhe banorët e saj gjatë periudhës 1998-1999 paskan qenë në zor e të përndjekur nga UÇK-ja, jo nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe e jugosllave. Krimet e pretenduara të UÇK-së nuk konsiderohen si raste të izoluara e sporadike, apo si krime të individëve të caktuar, por konsiderohen si (citoj): "pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të drejtuar ndaj Kundërshtarëve" (pika 17 e aktakuzës).

Sipas Komisarit të Lartë të OKB-së, në raportin e tij të 27 shtatorit, ka të dhëna që saktësojnë ngjarjet dhe ndriçojnë të vërtetën.

-Në Mitrovicë, menjëherë pas fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s, u vunë në shënjestër intelektualët dhe aktivistët politikë shqiptarë, sipas një liste të parapërgatitur nga policia me ndihmën e civilëve serbë...

-Në pothuajse një të tretën e rasteve të raportuara, janë kryer ekzekutime pa dallim ndaj civilëve kryesisht nga forcat e policisë dhe ato paraushtarake. Në shumicën e rasteve, burra të moshës ushtarake u vranë në postat e kontrollit të policisë, pas paraqitjes së dokumenteve të tyre të identifikimit, sepse ata ishin nga zonat që konsideroheshin si bastionet e UÇK-së.

-Në shumë raste, ishin kryer qitje mbi turmat e civilëve, shtëpitë ishin djegur dhe ata që u përpoqën të arratiseshin u qëlluan dhe u vranë. Në fshatin Gllansellë, komuna e Glogocit, paraushtarakët iu vunë zjarrin shtëpive duke vrarë kështu më shumë se 45 civilë, kryesisht gra të moshuara. Në Suharekë thuhet se gjatë zhvendosjes janë vrarë deri në 350 civilë. Në Prishtinë, ndërsa i shtynin njerëzit drejt stacionit hekurudhor, policia vrau disa civilë.

-Në fshatin Vrbovac, komuna e Glogocit, pas tërheqjes së UÇK-së, një grup prej rreth 50 civilësh u kapën, u urdhëruan të mblidheshin në rresht, u torturuan dhe u pushkatuan nga forcat paraushtarake. Në Skenderaj (Srbicë), pas ofensivës së UÇK-së dhe tërheqjes pasuese, u vranë 5 burra të moshuar. Në Pusto Selo (Pastasel) pas luftimeve midis UÇK-së dhe serbëve në zonë, forcat serbe dyshohet se pushkatuan 106 persona pasi i poshtëruan dhe i keqtrajtuan...

Për të gjithë botën, edhe për symbyllurit, ishte e qartë se në Kosovë po zhvillohej luftë e përgjakshme dhe po ndodhnin masakra të përbindshme.

Këto masakra do të kishin qenë në përmasa shumë më të mëdha, si ndodhi në Bosnje, nëse Kosova nuk do të kishte pasur Ushtrinë e saj Çlirimtare.

Prania dhe lufta e saj, e drejtë, në kohën e duhur dhe e imponuar solli përkrahjen ndërkombëtare dhe ndryshe nga marsi i vitit 1998, kur ende kishte dyshime mbi rolin dhe rëndësinë e saj, ajo u bë partner i domosdoshëm i politikës botërore.

Kjo solli për herë të parë në histori intervenimin e NATO-s, çka nuk kishte ndodhur asnjëherë dhe ndoshta as nuk do të ndodhë, kjo bëri që shefi i kësaj strukture, generali Klark ta cilësojë UÇK-në si "forca tokësore e NATO-s", kjo solli edhe përkrahjen ndërkombëtare në Rambuje, ku shefi i delegacionit ishte drejtori politik i UÇK-së, dhe diplomacia e kalibrit të rëndë nuk mund të ulj dhe të bisedonte me një terrorist, përfaqësues i një strukture që ishte e lidhur me krimin.

Kosova ndodhet para një gjendje të re, pasi në balancë nuk janë vënë rivënë fati i disa njerëzve, sado të rëndësishëm apo të parëndësishëm qofshin ata, por shumë përtej saj: e shkuara dhe ndërtimi i së ardhmes.

Në Hagë ndodhen disa prej njerëzve përfaqësues të saj, presidenti i Kosovës, dy ish kryetarë të Kuvendit, drejtuesi i grupit parlamentar të partisë më të votuar në Kosovë në zgjedhjet e fundit. Pra një konfiguracion i tërë politik, që ka lidhje me tri parti politike, PDK, NISMA dhe Lëvizja LV!, tri forca që kanë nisjen e saj nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe, më tej, me presidentin e Kosovës, që në jetën e tij politike të pasluftës ka pasur gjithë postet e mundshme qeveritare dhe shtetërore.

Aktakuza e ngritur ndaj tyre ka vënë përkohësisht në balancë vlerat e luftës dhe të domosdoshmërisë së saj, së bashku me të vërtetat.

Cilat janë ato?

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)





AC/DC (nga e majta në të djathtë): Cliff Williams, Brian Johnson, Angus Young, Phil Rudd dhe Stevie Young (foto: Josh Cheuse)

Rikthimi i AC/DC-së

Basisti u largua, këngëtari humbi dëgjimin, bateristi ishte në arrest shtëpie dhe anëtari themelues, Malcolm Young, vdiq nga demenca. Por, AC/DC... janë rikthyer. Pjesë të shkrimit të gazetarit Michael Hann, të publikuar në ditoren Guardian.

Në fund të koncertit të AC/DC-së, Angus Young e ka një rutinë. Pas disa orëve me lëvizje të përhershme, me veshjen e tij shkollore, ai shkon drejt dushit dhe, më pas, meqë nuk ka qenë në gjendje të hajë që nga mesdita – nuk mund të bësh koncert të AC/DC-së me stomakun e plotë – kërkon ushqim. “Gjëja e parë që futet në kokën time është: Po vdes nga uria.”

Kur u largua nga skena e Qendrës “Wells Fargo” në Filadelfia, më 20 shtator 2016 – natën e fundit të turneut “Rock or Bust” – mbase atë rutinë e ka kaluar për herën të fundit në historinë e atëhershme 43-vjeçare të grupit. 23 koncertet e fundit ishin përfunduar me Axl Rose-in si këngëtar (duhet thënë, në mënyrë të shkëlqyeshme), pasi problemet

e dëgjimit e kishin detyruar këngëtarin Brian Johnson të tërhiqej nga rrugëtimi. Thjesht, nuk mund ta gjente tonalitetin dhe çdo koncert ia bënte më të dobët dëgjimin. Atë verë, basisti Cliff Williams kishte thënë se edhe ai do të largohej nga grupi. Bateristi Phil Rudd nuk ia doli të jetë në turne, pasi u përfshi në atë që Young e kishte quajtur “punë kastravec”: u akuzua nga një gjykatë e Zelandës së Re për tentim-vrasje të ndihmësit të tij personal, plus për posedimin e metamfetaminës dhe kanabisit. Vëllai i Angus-it, Malcolm-i – de facto udhëheqësi i grupit – ishte larguar tashmë, për shkak të çmendurisë, për t’u zëvendësuar nga nipi i tyre Stevie. Pak më shumë se një vit pas koncertit final, Malcolm-i vdesë.

Pra, kur në shtator 2018 dolën

fytyrat e AC/DC-së – përfshirë Johnson-in, Williams-in dhe Rudd-in – në një studio në Vankuver, kjo dukej si mrekulli. Johnson-i, dëgjimi i të cilit është më i mirë falë asaj që ai i quan “veshët protezë”, pajtohet me këtë. “Thjesht e tregon aftësitë ripërtëritëse dhe lidhjen që ekziston mes nesh. Hymë në studio dhe ju mund ta ndjenit elektricitetin në ajër. Dhe, sigurisht, Malcolm-i ishte atje. Ishte atje me një frymë aq të fortë, sa që ishte i dukshëm. Mendoj se të gjithë mund ta ndiejmë atë”.

Kur Williams u pyet nëse kishte prituri të ndodhte kjo, përgjigjja e tij është: “Jo”, dhe shpërthen në të qeshura. Por, Young – që nga largimi i Malcolm-i është mbreti i padiskutueshëm i grupit – thotë se gjithmonë kishte menduar se historia e tyre nuk ka përfunduar. “Kuptova, në një moment, se kompania e regjistrimeve ose dikush do të më thoshte: ‘A mendon se mund të bësh diçka?’ ‘Kështu që e kisha këtë në pjesën e pasme të kokës’”. Por, ja ku jemi me “Power Up”-in, studio-albumin e 17-të që është pak më i mirë sesa dikush mund të mendojë. Do të ishte e paarsyeshme të prisnim një

“Powerage” tjetër, “Highway to Hell” ose “Back in Black” në këtë pikë, por “Power Up” është vërtetë album i mirë, shumë më i mirë se disa të fundit. Ka edhe befasi: “Through the Mists of Time”...

“Kam mornica kur e dëgjoj këtë këngë”, thotë Johnson. “Mund ta dëgjoj Malcolm-in përmes asaj kënge. Është një kthim në ditët kur rokenrolli ishte shumë argëtues e ne ishim më të rinj dhe dukej sikur asgjë nuk do të mbaronte dhe se gjithmonë do të ishte jeta si në fillim të viteve 1980... Ndaj, kur e dëgjoj, është pothuajse si udhëtimi në kohë”. Origjina e albumit “Power Up” daton që nga vitet e para të këtij shekulli. Pas përfundimit të turneut “Stiff Upper Lip”, më 2001, grupi kishte pushuar për shtatë vjet, por Angus-i dhe Malcolm-i vendosën të punojnë për të shkruar jo vetëm këngë të tëra. Young thotë se kaluan pesë vjet në studio duke grumbulluar materiale për albumin “Black Ice” të vitit 2008.

A ishte diagnostikuar Malcolm-i me demencë? A po grumbullonin materiale kundër ditës kur ai nuk do të ishte më në gjendje të shkruante? “Kishte momente të çuditshme

gjatë asaj kohe... mund të shihnit se diçka nuk ishte në rregull. Por, ende e mbante veten mirë”, thotë Young. “Kështu që, për këtë album isha i vendosur të përdorja disa nga idetë për të cilat ai kishte bërë shumë përpjekje”.

Young thotë se shkoi në studio për të bërë “Power Up”-in me këngët – të gjitha nga Young dhe Young – edhe pse Williams-i ka një kujtim pak më ndryshe: “Ang dhe Mal kishin një mal me ide për rifet dhe gjërat që Angus i nxirrte. I identifikoi 12 prej tyre dhe ne i përpunam në studio”. Johnson shton: “Kur ishim në studio dhe po provoja të këndoja disa rreshta, thjesht më ndizej diçka në mendje: ‘A e dëshironte kështu Malcolm-i këtë këngë?’ Ishte karakter i fortë. E meritonte respektin pa u munduar për të. Dhe, edhe pse nuk është më me ne, është ende atje”.

Identifikimi i e AC/DC-së nuk është veç te rifat, uniforma e shkollës dhe volumi. Është gjithashtu sensi i shoqërisë që e projektojnë. Kjo nuk do të thotë se të gjithë kanë qenë miqtë më të mirë që nga dita kur u takuan (megjithëse Williams dhe Johnson janë shumë të afërt), sepse vëllezërit Young ishin

gjithmonë të pamëshirshëm në vendimet e tyre për atë që ishte më e mira. Por, AC/DC përfaqëson një vend dhe koncertet e tyre ishin e vetmja gjë me rëndësi. Ngjarjet e vitit 2016 e ndryshuan këtë, veçanërisht me deklaratën e shkurtër që njoftonte largimin e Johnson-it. Një mik i Johnson-it i tha shtypit se këngëtari ndjehej "i shkelur".

"Gjithmonë mund të kesh në mendje një gjë se mund të ishte bërë më mirë", pranon Young. "Por, situata ishte: çfarë të bëjmë në rast urgjence?"

Johnson-i e lëshoi një deklaratë duke mohuar se ishte mënjanuar dhe tani thotë se e mbështeste vendimin e grupit për të vazhduar pa të. "Ishte ndjenjë e tmerrshme kur i zhgënjën djemtë e grupit", thotë ai. "Po e zhgënjën veten, lojtarët, dhe besimi yt përmbysset. Nuk mund ta kesh këtë në një grup si AC/DC ku duhet të jesh sulmues dhe në qendër. Nuk mund të fshihesh pas Angus-it gjatë gjithë kohës. Trupi ka dështuar: kjo u ndodh futbollistëve, sportistëve... Ishte radha ime dhe kaq".

Pastaj ishte Williams-i ai që u largua, duke e shndërruar turneun në një makth. Goditja tjetër vjen me Rudd-in, sepse askush nuk mund ta kishte tingullin e tij për tupanat. Johnson thotë: "Kur bëhen bashkë Cliff-i dhe Phil-i, njeri, është vështirë të gjesh diçka si kjo".

Kur dolën raportet për krimet e tij – përfshirë akuzën për tentim-vrasje e cila u tërhoq për mungesë provash – grupi u trondit. "Isha duke pirë një



filxhan kafe", thotë Johnson. "Dhe, Phil-i ishte në ekran. Thash: 'Çka?' Phil ishte në gjendje të keqe atëherë. Po merrte disa kokteje të këqij [të drogës] ose diçka tjetër". Në fakt, fotot në kohën e arrestimit e shfaqën një burrë tërësisht të dërrmuar. U dënua me tetë muaj arrest shtëpie. "Ky nuk ishte Phil-i që ne e njihnim. Është djali më qesharak, më i pastërti që njoh. Isha kaq i trishtuar. Por, fatmirësisht tash është në rregull", shton Johnson.

Kthimi i Rudd-it ndodhi përmes funeralit të Malcom Young-ut, në shtator 2017. "E pash Phil-in në funeralin e

Malit dhe dukej shumë mirë", thotë Angus. "Më tha se kishte punuar me ata tipat e rehabilitimit dhe se ende ka kontakte me njerëzit që e ndihmonin. I thashë: 'Sapo ta mbledh materialin, do të lidhemi'".

Dikush mund të mendoj se mbledhja e grupit kërkonte reagimin e Angus-it. Por, është gabim.

"Angus bisedoi me menaxhmentin dhe menaxhmenti ra në kontakt me secilin prej nesh", thotë Johnson. Young – duke folur në një telefonatë tjetër – e paraqet këtë pak më ndryshe. "Brian më ka thënë se nëse bëj diçka

dëshiron të jetë i përfshirë".

Pasi u mblodhën, u stabilizuan menjëherë. "Ishte e natyrshme", thotë Williams. "Kemi qenë së bashku kaq gjatë".

Angus Young mund të kishte bërë "Power Up"-in me Stevie Young-un plus me një këngëtar tjetër dhe instrumentistë të angazhuar. Sepse, brendi AC/DC ka mbijetuar nga përmbysjet që shkatërruan grupet e mëdha, veçanërisht nga vdekja e paraardhësit të Johnson-it, Bon Scott, në shkurt të vitit 1980. Kështu, koncertet e vitit 2016 me Axl Rose-in (Chris Slade ishte në tupana) ishin fantastike. "Nuk e njihnim Axl-

in", thotë Williams, "por, e bëri një punë të shkëlqyeshme". Thotë se "ishte një vibrim tjetër" "se Axl-i ishte për respekt e se punoi me shumë përkushtim".

Por, për një album të AC/DC-së duhej një lidhje me historinë e grupit e jo vetëm me Angus Young-un. Williams thotë se "po të mos ishin Brian-i dhe Phil-i, nuk do të isha as unë". A beson Young-u se mund ta kishte bërë "Power Up"-in pa ta?

Përgjigja e tij shkon përsëri te Malcolm-i dhe reflekton tingujt unikë të kitarës së Pete Townshend-it dhe Keith Richards-it e nuk ka asnjë lidhje me pyetjen që ia bëra. Ai bën me dije se e dinte se duhej t'i ketë me vete, por nuk e thotë këtë.

Me albumin e kryer, iu desh të përpunonin edhe në një gjë të fundit: a do të mund të këndonte Johnson-i, në koncerte?


"Të gjithë u mblodhëm në Holandë në një vend për prova. I donim kushtet e fushëbetesës", thotë Johnson-i. "Djemtë u vendosën prapa e unë me këto protezat që ma ndryshuan jetën. Mund të dëgjoja gjithçka. Nuk e besoni se çfarë ndjenje është".

"Kështu, e kënduam një këngë dhe ai ishte në rregull", kujton Young. "Donte të bënte më shumë. Kjo është gjëja më e çmendur që kam parë në vite".

"Sigurisht, gjendja e tashme e botës do të thotë se duhet të presim edhe pak për turne. Por, një ditë, dhe shpresojmë shumë shpejt, do të vijë ora njëmbëdhjetë e natës dhe një Angus Young i dërrmuar do ta lë skenën i veshur vetëm me pantallona të shkurtra, çorape dhe këpucë, flokët e çaraveshura... Do ta bëjë një dush dhe do të pyesë se çfarë mund të hajë. /Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Kosova e pafat ndaj Sllovenisë, Shqipëria shkeli Kazakistanin



PRISHTINË, 15 NËNTOR (ER) - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është treguar e pafat në ndeshje e Ligës së Kombeve, pasi pësoi humbje në fund të ndeshjes nga Sllovenia (2-1). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0. "Dardanët" e nisën mirë pjesën e dytë dhe arritën që të parat të kalojnë në epërsi, kur Vedat Muriqi shënoi në minutën e 58-të. Vendasit u rikthyen shpejtë në lojë dhe e barazuan rezultatin pas pesë minutave me anë të Jasmin Kurtiq. Në minutat shtesë, Fidan Aliti luajti me pjesën e krahut në zonën e rreptësisë, por gjyqtari vendosi të akordoi penalti dhe nga pika e bardhe i pagabueshëm ishte Josip Iliq për rezultat final 2-1. Pas kësaj ndeshje, Sllovenia renditet në vendin e parë me 13 pikë, kurse Kosova zë vendin e tretë me 2 pikë. Kosova tri ditë më parë është mposhtur nga Shqipëria në ndeshje miqësore (2-1), në "Elbasan Arena", kurse më 18 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret Moldavinë në ndeshjen e fundit për këtë edicion të Ligës së Kombeve.

Shqipëria është ende në garë për vendin e parë në Grupin 4 të Ligës C. Kuqezinjët e mposhten me lehtësi 3-1 ndaj Kazakistanit në "Air Albania Stadium". Në minutën e 16-të, Solok Cikalleshi e shfrytëzoi asistimin e Memushajt për rezultatin 1-0, kurse shtatë minuta më pas Shqipëria arriti që të gjejë një tjetër gol. Mbrojtësi Ismajli shfrytëzoi më së miri një përgjumje të kazakëve për ta dërguar në rrjetë. Mysafirët përfitojnë nga një dalje shumë e gabuar e Etrit Berishës. Abat Aymbetov lëshoi një goditje nga mesi i fushës duke e dërguar në rrjetën e portierit që luan te SPAL në Itali. Në minutën e 62-të, Abrashi pas një këmbëngulje të gjatë arrin që të fitojë një penalti. Nga pika e bardhë, Rey Manaj nuk gabon duke e dërguar topin në rrjetë për rezultatin final 3-1. Shqipëria me këtë fitore ngjitet në kuotën e 8 pikëve, dy më pak se Bjellorusia, që do të jetë edhe rivali në sfidën e fundit që do të luhet të mërkurën.

Anglia mposhtet nga Belgjika, Italia triumfon ndaj Polonisë

Anglia ka pësuar humbjen e radhës në Ligën A të Kombeve. Ajo u mposht nga Belgjika me rezultat 2-0. Golat për belgët i shënoi Youri Tielemans në minutën e 10-të të ndeshjes dhe Dries Mertens, në të 24-ën. Pas kësaj fitoreje, Belgjika radhitet e para në Grupin 2, me 12 pikë ndërsa Anglia është në vendin e tretë, me shtatë sosh. Me këtë fitore, Belgjika ia ka shuar gjasat Anglisë që të kualifikohet për në finale të Ligës së Kombeve. Pas Belgjikës, në këtë grup ka lëvizur tutje edhe Danimarka, e cila renditet e dyta në tabelë. Skuadra e Italisë ka mposhtur Poloninë në ndeshjen e Ligës së Kombeve. Ndeshja përfundoi 2-0, ku golin e parë në ndeshje e shënoi Jorginho, në minutën e 27-të nga pika e bardhë dhe Berardi, pesë minuta para fundit të takimit. Pas kësaj fitoreje, Italia renditet e para në Grupin me 9 pikë, ndërsa Polonia e treta me shtatë pikë.

KHF Ferizaj eliminohet nga garat evropiane

Antalya, 15 nëntor - KHF Ferizaj është eliminuar nga Kupa Evropiane. Në kuadër të rrethit të tretë të kësaj gare, kampioni i Kosovës në konkurrencë të femrave u përball me skuadrën turke Muratpasha Belediyesi. Të dyja ndeshjet janë luajtur në Antalya të Turqisë. Ndeshjen e parë, të luajtur të

shtunën, Ferizaj e humbi me rezultat 40:15. Ndeshja e dytë e luajtur të dielën përfundoi 32:16 në të mirë të skuadrës turke që kështu avancon tutje. Albulena Kelmendi i realizoi pesë gola për Ferizajn. Kaltrina Domaneku e Aida Stagova shënuan nga tri herë.



SHKURT

Mustafi në listën e Barcelonës

Te Barcelona kanë filluar të mendojnë që tani për përforcimet që do të bëjnë në afatin kalimtar të janarit. Një nga repartet ku katalanasit duan të përforcohen është mbrojtja, ku në janar pritet largimi i Samuel Umtiti dhe trajneri Roland Koeman dëshiron një tjetër lojtar në vendin e tij. Për shkak të situatës së krijuar në klub, ku në fund të janarit janë zgjedhjet presidenciale, klubi është i detyruar të bëjë përforcime me kosto të ulët. Për këtë arsye, sipas "Diario Sports", do të tentohet afrimi i një mbrojtësi që nuk kushton shumë dhe një nga lojtarët e pikëtuar është futbollisti shqiptar Shkodran Mustafi. Mbrojtësi nuk po kalon një periudhë shumë të mirë të "Topçinjtë" dhe në janar mund të shikojmë në radhët e Barcelonës.

Trajneri i Torinos infektohet me Covid-19

Trajneri i Torinos, Marco Giampaolo, ka dalë pozitiv pas tamponit për Covid-19. Ish-trajneri i Milanit mori një përgjigje shumë të keqe që i ndikon dhe me qëndrimin e tij në krye të stolit. Numri një i stolit me shumë mundësi nuk do të jetë i pranishëm në sfidën kundër zikaltërve. Giampaolo është izoluar menjëherë dhe po ndjek protokollet mjekësore.

Të gjithë mbrojtësit e Liverpoolit janë lënduar

Liverpooli duket se po kalon një sezon të mallkuar. Trajneri Jurgen Klopp nuk ka në dispozicion asnjë nga mbrojtësit titullarë. I fundit që i është shtuar infermierisë është Andy Robertson, i cili është dëmtuar dhe do ta humbasë ndeshjen me Sllovakinë për shkak të një dëmtimi muskolor. Të lënduar janë edhe Van Dijk, Gomez dhe Arnold. E gjitha mbrojtja titullare e kampionëve do të mungojë për trajnerin Klopp. Liverpooli nuk ka të disponueshëm as Salah, i cili është prekur nga Covid-19, ndërkohë që Thaigo Alcantara po ashtu është i lënduar.

Joan Mir kampion në MotoGP

Motoçiklisti i Suzukit, Joan Mir, e ka fituar titullin e kampionit në serinë MotoGP. Spanjollit Mir i ka mjaftuar pozita e shtatë në garën në Valencia sot, për ta siguruar titullin e kampionit. Ai është motoçiklisti i parë i Suzukit në dy dekada që e fiton titullin e kampionit. Mir nisi garën me një epërsi prej 37 pikëve ndaj rivalit më të afërt dhe ka arritur ta mbajë epërsinë. Ai është bërë motoçiklisti i parë i Suzukit, pas amerikanit Kenny Roberts Jr., në vitin 2000, që e fiton titullin e kampionit në MotoGP.

Hamiltoni shpallet kampion për herë të shtatë, barazohet me Schumacherin

STAMBOLL, 15 NËNTOR - Lewis Hamiltoni është një legjendë në Formula 1. Piloti britanik fitoi çmimin e madh të Turqisë ditën e sotme dhe siguroi fitimin e

titullit kampion bote. Britaniku ka barazuar rezultatin e ish-kampionit të botës, Michael Schumacher, me shtatë tituj kampionë bote. Ai ishte goxha i

shkëputur nga pjesa tjetër e pilotëve, pasi Perezi dhe Vetteli përfunduan pas tij. Çmimi i madh i Turqisë pati rivalitet dhe të papritura, pasi reshjet e shiut ndikuan

në garë. Pilotët u përplasën, ndërsa e gjitha skena ishte fatlume për Ferrarin që e mbyll në vendin e tretë me Vettelin dhe të katërtin me Leclerc.



Ylli fiton pas vazhdimeve ndaj Vëllaznimit

PRIZREN, 15 NËNTOR - Golden Eagle Ylli ka mundur Vëllaznimitin 87:74 (20:17, 20:14, 21:14, 9:25, 17:4), në kuadër të javës së pestë të Prince Caffë Superligës. Loja ishte interesante, por vendësit e fillojnë më mirë, duke pasur epërsi 15:6, por mysafirët kundërpërgjigjen në fund të çerekut të pare, duke ngushtuar shifrat në 20:17. Skuadra kuqezi vazhdon me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke kaluar në epërsi 22:23, megjithatë, vendasit me një seri prej 5:0, sërish kalojnë në epërsi 27:23. Më pas zhvillohet lojë interesante, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 40:31. Ylli e nisi furishëm pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë, duke pasur epërsi deri në 22 pikë (54:32), kurse rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 61:45. Në 10 minutat e fundit, Vëllaznimiti nuk u dorëzua dhe afron shifrat në 66:64, duke e bërë ndeshjen edhe më interesante. Dramë u zhvillua deri në fund, kur Hortman i Vëllaznimit gjuan saktë nga 8 metra për tri pikë dhe barazon rezultatin në 70:70, 25 sekonda nga fundi. Ylli nuk shfrytëzoi aksionin e fundit dhe



skuadrat shkuan në vazhdime. E, në vazhdime Ylli nuk lëshoi pe dhe fitoi në fund me rezultat 87:74. Te Golden Eagle Ylli u dallua Valon Bunjaku me 19 pikë, 12 kërcime dhe 11 asistime, kurse te Vëllaznimiti më i miri ishte Christopher Hortman me 30 pikë, 19 kërcime e 7 asistime. Golden Eagle Ylli ka tri fitore dhe një humbje, kurse Vëllaznimiti një fitore dhe katër humbje. Ndërsa Rahoveci e ka mundur Bashkimin në Prizren me

rezultat 87:89 (13:23, 22:26, 25:23, 27:17), në kuadër të javës së pestë të Prince Caffë Superligës. Nikola Vukçević ishte më i dalluari te Bashkimi me 32 pikë, kurse te Rahoveci u dalluan treshja Isaiah Traylor me 28 pikë, 10 kërcime e 8 asistime, Alban Veseli me 27 pikë e 7 kërcime dhe Marvin Jones me 19 pikë. Bashkimi ka një fitore dhe tri humbje, kurse Rahoveci tri fitore dhe dy humbje.

Istogu i merr pikë Lirisë, Vitia e Ulpiana ndahen 'paqe'

PRIZREN, 15 NËNTOR - Kanë përfunduar të gjitha ndeshjet e xhiros së dhjetë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll për Grupin A dhe Grupin B. Në derbin e zhvilluar në Prizren, Liria nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë kundër Istogut (1-1). Për vendasit realizues i golit nga penalltia ishte Qëndrim Gashi, kurse për "troftat" realizoi Qëndrim Jahaj. Në ndeshjen tjetër, Onixi luajti baras me Malishevën (1-1). Në Grupin A, Malisheva dhe



Onixi janë në vendin e parë dhe të dytë me nga 20 pikë të grumbulluara. Në Grupin B, Vitia ndau pikët me Ulpianën (0-0), kurse Kika

GRUPI A	
Liria - Istogu	1-1
Onix - Malisheva	1-1
A&N - Vushtrria	3-0
Dukagjini - Vëllaznimiti	7-0
Trepça - Drenasi	1-1
GRUPI B	
Flamurtari - Vllaznia	1-1
KEK-u - Ferizaj	2-0
2 Korriku - Dardana	0-1
Vitia - Ulpiana	0-0
Kika - Ramiz Sadiku	1-3

pësoi humbje me rezultat 1-3 nga Ramiz Sadiku. Në këtë grup Ulpiana është e para me 17 pikë, kurse Vitia e dyta me 16 pikë.

SHKURT

Messi ka dy kushte për kalimin te City

Lionel Messi ia ka bërë të qartë Manchester Cityt se nëse duan ta transferojnë, atëherë në skuadër duhet të jenë Pep Guardiola dhe Sergio Aguero. Këta të dy janë çelësi që argentinasi në verën e ardhshme të transferohet në "Etihad" ose të nënshkruajë kontratë paraprake në afatin e janarit. Në garë për Messin vazhdojnë të jenë edhe klubet e tjera të mëdha si PSG-ja dhe Interi.

Boateng: Jam i befasuar nga Bayerni

Aventura e mbrojtësit Jerome Boateng te Bayern Muncheni do të mbyllet në fund të këtij sezoni pas plot 10 vjetësh që mban veshur fanellën e "bavarezëve", pasi drejtuesit e klubit kanë vendosur të mos i rinovojnë kontratën. Mbrojtësi 32-vjeçar është shprehur i befasuar nga vendimi, pasi deri tani kishte qenë në pritje të një kontrate të re. "Askush nuk më është afruar dhe nuk më ka folur. Nuk e dija që nuk do të më rinovonin bashkëpunimin, ndaj mbeta i befasuar", ka thënë Boateng për "Suddeutsche Zeitung".

Conte, Eriksenit: Të gjitha zgjedhjet i bëj për të mirën e Interit

Christian Eriksen dëshiron të jetë në formacionin bazë të Interit, por Antonio Conte vijon të mendojë se ai ende nuk e meriton për të qenë titullar. "Erikseni dëshiron të luajë më shumë? Të gjitha zgjedhjet që bëj janë gjithmonë dhe vetëm për të mirën e Interit, jo për interesin e lojtarëve të veçantë. Vidal? Është lojtar i shkëlqyeshëm. Ai gjithmonë di çfarë të bëjë në fushë. Do t'i dureshin dy javë të plota stërvitje për ta kapur formën maksimale, por ai po luan vazhdimisht, gradualisht po arrin aty ku duhet", ka thënë Conte.

Juve dhe Interi në garë për Çalhanoglu

Dy klubet italiane, Interi dhe Juventus, janë të interesuara që gjatë janarit ta transferojnë anëtarin e Milanit, Hakan Çalhanoglu. Turkut i skadon kontrata në qershorin e vitit 2021 dhe negociatat që ta rinovojë kontratën thuhet se janë të komplikuar. 25-vjeçari fiton 2.5 milionë euro për sezon dhe agjenti ka bërë kërkesë që paga t'i rritet në pesë ose gjashtë milionë euro për sezon. Sipas "Tuttosport", Interi dhe Juventus janë të interesuar për ta transferuar mesfushorin e talentuar, derisa "Zonja e Vjetër" ka ofruar Federico Bernardeschin për ta shkëmbyer në janar. Sidoqoftë, ideja e Milanit është ta mbajë lojtarin deri në fund edhe nëse kjo nënkupton që të humbin pa fituar para.

Presidenti i La Ligës: Nuk na mungon Ronaldo

Presidenti i La Ligës, Javier Tebas, këmbëngul se kampionatit spanjoll nuk i mungon Cristiano Ronaldo. Në një intervistë për "Marca", ai deklaroi se Seria A nuk

është përmirësuar shumë me transferimin e CR7 në Itali. Gjithashtu, spanjollit flet edhe për një largim të mundshëm të Lionel Messit nga Barcelona apo dhe Sergio Ramosit nga Real Madridi. "Ma kujtojnë shpesh largimin

e Ronaldos në 'Twitter', por unë dua t'ju siguroj se asgjë nuk ka ndryshuar për ne. Të them të drejtën, nuk mendoj se kampionati italian është përmirësuar shumë tashmë që ai luan atje, madje ata as nuk e vunë re diçka të tillë", ka

thënë 58-vjeçari. "Largimet e Messit dhe Ramosit? Padyshim që nuk dua që ata të largohen nga La Liga, por nëse kjo do të ndodhte, atëherë ne të gjithë duhet të japim më shumë për t'i zëvendësuar ata. Edhe

Neymari u transferua te PSG-ja, por Liga 1 mbetet Liga 1. Marka e La Ligës dhe klubet e mëdha që marrin pjesë janë mbi çdo lojtar individual, pavarësisht se sa i talentuar mund të jetë ai", ka shtuar Tebas.

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhësi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË
(1990-1991)




“A po shkruan Barney?”
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
 “A po të shiten librat?”
 “Po marrë çeçe nga të drejtat e autorit”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”
 “Për femrat moderne”.
 “Për femrat moderne?!”
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrsisht të këqija”.
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkitën dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €



Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI
EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPÇTINA LIPJAN

Pranuar më:
Punëjeto: 13-11-2020

Njësia Lajmëtar	Numri Brogj	Shifra Dodatë
4-610	-56363	

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Ismail Luma"
Komuna: Lipjan
Data: 16.11.2020

Numri i kontratës: ESIP/SDG/024-G/1.5	Emri i kontratës: Mjete konkretizimi për klasat 1-9
--	--

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës SHFMU "Ismail Luma", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Mjete konkretizimi për klasat 1-9
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Ismail Luma" Lipjan, më së largu deri më 24.11.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla veçem atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Driton Sadiku
Telefoni: 044/ 741 - 608
E-maili: dritoni.sadiku@hotmail.com

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shkelzen Gashi shpall te pa vlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha " ne Gjakovë.
- ▶ Fisnik Mamusha shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.E. " Kadri Kusari " ne Gjakovë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepe shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

